

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5807
E premte, 21 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Ministri Tahiri viziton Komunën e Bujanocit

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

NJË PROGRAM PËR QEVERISJE TË MIRË OSE NJË PROGRAM PËRTEJ PARTIVE POLITIKE F. 12

Jakup KRASNIQI



KUR DO TË KETË AKUZA PËR GJENOCID NË KOSOVË? F. 11

Bardhyl MAHMUTI



AKTUALE

KOSOVA DHE TURQIA NËN SHKRUAJNË PLANIN E VEPRIMIT PËR BASHKËPUNIM NË SHËNDETËSI F. 5

EKONOMI



MBI 60 PËR QIND E QYTETARËVE NË MOSHË PUNE NUK JANË EKONOMIKISHT AKTIVË F. 9

ZVICRA RATIFIKOI MARRËVESHJEN PËR SIGURIME SOCIALE ME KOSOVËN F. 9

SPORT

SPORTISTËT, TË ZHGËNJYER ME POLITIKËN F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", MAZLLUM BARALIU | FAQE 4-5

Reforma zgjedhore nuk mund të përfundojë këtë vit

Njohësi i proceseve zgjedhore, Mazllum Baraliu, e ka quajtur të drejtë veprimin e shoqërisë civile për ta pezulluar pjesëmarrjen në punën e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor. Ai ka thënë se kjo notë proteste është shenjë alarmuese se Ligji për financimin e subjekteve politike asnjëherë nuk ka arritur ta realizojë synimin e tij. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Baraliu ka shprehur skepticizëm se procesi i reformës zgjedhore mund të përfundojë këtë vit. Ai ka thënë se pa seriozitet politik dhe pa profesionalizëm nuk do të ketë reformë zgjedhore të mirëfilltë këtë vit



SAMITI I PARISIT, QË ËSHTË PARAPARË TË MBAHET
MË 1 KORRIK, MUND TË DËSHTOJË

Organizimi i Samitit të Parisit, në pikëpyetje



Samiti i Parisit, i paraparë të mbahet në fillim të muajit korrik, ka gjasa të dështojë. Liderët institucionalë të Kosovës kanë thënë se nëse samiti, i iniciuar nga kancelarja gjermane Angela Merkel dhe

presidenti francez Emanuel Macron, nuk përgatitet mirë, ai mund të shtyhet ose mund të mos organizohet fare. Sipas tyre, Kosova është e gatshme për këtë samit dhe për vazhdimin e dialogut me Serbinë

FAQE 3

Beqaj jep
dorëheqje
nga posti i
ministrit:
Drejtësia do ta
vërtetojë
pafajësinë
time | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasat, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pas përgjimeve të "Bild"-it, prokurorët gjermanë zbarkojnë në Shqipëri

TRANË, 20 QERSHOR - Hetimet për krimin e organizuar dhe trafikun e drogës ishin dy prej çështjeve që u diskutuan të enjten gjatë një takimi që kryeprokurorja Arta Marku zhvilloi me përfaqësues të Prokurorisë gjermane, të përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm i Mynihut Reinhard Röttle, drejtuesi i

Prokurorisë së Mynihut Georg Freutsmiedl, drejtuesi i Prokurorisë së Landshut Alfons Obermeier si dhe drejtues të tjerë të këtyre prokurorive. Qëllimi i takimit ishte ndërtimi i një marrëdhënie pune më të mirë në mes të institucioneve dhe forcimi i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet

e drejtësisë kriminale. Çështjet për diskutim u përqendruan në hetimet lidhur me krimin e organizuar dhe trafikun e drogës. Nuk dihet nëse mes palëve pati diskutime për përgjimet e "Bild"-it dhe ndonjë hetim të mundshëm në Gjermani se si kanë mbërritur informacionet nga Shqipëria në duart e gazetarit gjerman.



Ambasadori Kosnett thotë se Kosova duhet ta pezullojë përkohësisht taksën

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë (ShBA), Philip Kosnett, ka thënë se Kosova duhet ta pezullojë përkohësisht taksën si hap i parë për rikthimin e dialogut. Ai ka theksuar se miqësia e Kosovës me ShBA-në është e fort si guri dhe askush nuk duhet të dyshojë në këtë miqësi

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, në një intervistë për portalin "RajoniPress", ka folur për taksën dhe mospajtimet në këtë raport me Qeverinë e Kosovës për dialogun me Serbinë, për zyrat me aktakuza të ngritura dhe luftën kundër krimit të organizuar, për liberalizimin e vizave dhe për porosinë e tij që kosovarët të jenë optimistë. Kosnett ka thënë se pozicioni i qeverisë amerikane është që dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është i nevojshëm që të krijojë paqe, drejtësi dhe prosperitet për qytetarët e të dyja vendeve. Ai ka theksuar se ShBA-ja fuqimisht e mbështet kthimin e shpejtë në dialog. "Ne besojmë se të dyja qeveritë, ajo e Prishtinës dhe e Beogradit, duhet të ndërmarrin hapa dhe t'i qasen dialogut në mënyrë kreative si dhe në të drejtën e

kompromiseve dhe të ndërmarrin hapa që, ndoshta, nuk janë të popullarizuar për asnjërin vend", është shprehur ai. Ambasadori amerikan ka thënë se Kosova duhet që përkohësisht ta pezullojë taksën e vendosur ndaj produkteve të Serbisë. "Ne mendojmë se nga pala kosovare do të duhej të kishte një pezullim të përkohshëm të taksës si hap i parë për rikthimin e dialogut, në të njëjtën kohë kërkojmë që edhe Beogradi të ndërmarrë hapa për fillimin e procesit sërish. Dua të them se është mendim i qeverisë amerikane që negociatorët e të dyja palëve duhet të kenë liri që të vendosin vetë për çfarë duan të flasin. Kur qeveria amerikane tha vitin e kaluar se nuk do ta kundërshtonim bisedën për rregullimin e kufirit, nuk thamë se e parapëlqejmë rregullimin e kufirit, por vetëm po themi që negocia-



torët duhet të jenë të lirë të bisedojnë për atë që duan", ka deklaruar Kosnett. Ai ka shtuar se miqësia e Kosovës me ShBA-në është e fortë si guri dhe askush nuk duhet të dyshojë në këtë miqësi. "Në të njëjtën kohë është e natyrshme që të dy qeveritë tona të kenë mospajtime ndonjëherë lidhur me ndonjë çështje politike, por kjo nuk do të thotë se miqësia jonë është në krizë.

Prapë po e them se jo vetëm në interes të Amerikës, por është edhe në interes të Kosovës që taksa të hiqet përkohësisht, që të fillojë procesi prapë i dialogut", është shprehur ambasadori Kosnett. Ambasadori amerikan ka dhënë edhe një mesazh për kategorinë e politikanëve, deputetëve dhe strukturave qeveritare të cilët kanë aktakuza për korrupsion. "Do të thosha që ironitë janë

shumë të qarta dhe është në dorën e kosovarëve të kërkojnë sinqeritet dhe lidhshmëri, qoftë nga ata që janë në Kuvend, por edhe nga qeveria. Për ta përmbytur demokracinë në Kosovë nuk duhet njerëzit vetëm të ulen dhe të shikojnë, ky nuk është sport i tillë sepse për ta mundësuar një demokraci të vërtetë njerëzit duhet të reagojnë dhe punojnë për të", ka thënë ambasadori Kosnett.

DASH: Kosova s'i ka përmbushur standardet për eliminimin e trafikimit të njerëzve

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Qeveria e Kosovës nuk e ka përmbushur as nivelin minimal të standardeve për eliminimin e trafikimit të njerëzve, por po bën përpjekje të rëndësishme në këtë drejtim, thuhet në raportin vjetor të Departamentit të Shtetit lidhur me trafikimin me njerëz në 187 vende dhe rajone të botës. Megjithatë raporti njih disa rezultate, siç është rishikimi i Kodit Penal të Kosovës në të cilin riklasifikohen të gjitha veprat e detyruara të prostitucionit si trafikim, si dhe emërimi i një koordinatori rajonal të Prokurorisë, theksohet se, megjithatë, qeveria nuk i plotëson

as standardet minimale në disa fusha kyçe. "U dënuan më pak trafikantë dhe u identifikuan më pak viktime. Gjyqtarët vazhduan të shpallin dënime të ulëta për trafikantët e dënuar", thuhet në raportin e Departamentit të Shtetit, ka njoftuar rfe. Raporti përmend faktin se Qeveria e Kosovës uli fondet për strehimore të OJQ-ve për të katërtin vit radhazi, duke detyruar OJQ-të të mbështeten në donatorë të huaj. Në rekomandimet që bëhen në raport sa i përket Kosovës, theksohet se autoritetet duhet t'i hetojnë, ndjekin penalisht dhe t'i dënojnë trafikantët si dhe të

shpallin dënime të larta, pastaj të sigurojnë fonde për strehimoret e OJQ-ve.


Departamenti Amerikan i Shtetit thekson se institucionet e Kosovës duhet të caktojnë prokurorë dhe gjykatës të trajnuar për rastet e trafikimit. Një çështje tjetër që theksohet si rekomandim është zvogëlimi i rasteve të lëndëve në gjykata, përfshirë rastet e trafikimit të njerëzve. "Duhet standardizuar mbledhja e të dhënave dhe të krijohet një bazë e të dhënave për statistikën e trafikimit, pastaj të ndjekjeve penale dhe dënimeve që ndërlidhen me trafikimin", thuhet në raport.



Samiti i Parisit, që është paraparë të mbahet më 1 korrik, mund të dështojë

Organizimi i Samitit të Parisit, në pikëpyetje

Samiti i Parisit, i paraparë të mbahet në fillim të muajit korrik, ka gjasa të dështojë. Liderët institucionalë të Kosovës kanë thënë se nëse samiti, i iniciuar nga kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emanuel Macron, nuk përgatitet mirë, ai mund të shtyhet ose mund të mos organizohet fare. Sipas tyre, Kosova është e gatshme për këtë samit dhe për vazhdimin e dialogut me Serbinë

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Liderët institucionalë në Kosovë kanë vënë në pikëpyetje mbajtjen e Samitit të Parisit i cili pritet të mbahet më 1 korrik dhe pritet të diskutohet për vazhdimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Pas kryeparlamentarit Kadri Veseli, edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka paralajmëruar se samiti, i cili është iniciativë e kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit francez Emanuel Macron, mund të shtyhet nëse nuk përgatitet mirë. "Sa i përket Samitit të Parisit, nëse përgatitjet shkojnë mirë, me siguri se do të mbahet, por nëse nuk janë kryer përgatitjet, atëherë mund të shtyhet. Kemi paralajmëruar edhe në të kaluarën se mund të ndodhë që të shtyhet", ka thënë Haradinaj në një konferencë për medie.

Ai ka deklaruar se Kosova është e përgatitur për këtë samit, duke shtuar se edhe vetë është marrë për koordinimin ndërmjet institucioneve për këtë çështje. "Në Kosovë gjendja është mirë në mes të institucioneve dhe mes atyre që punojnë. Pra, kemi koor-

dinim të mjaftueshëm. Unë vetë kam bërë kujdes në koordinim me të gjithë. Kosova ka qëndrimin e vet për temat që do të diskutohen në këtë samit. Pra, kemi përgatitur qëndrimin tonë në këtë samit", është shprehur Haradinaj.

Një ditë më parë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se nuk shkon në këtë samit nëse aty do të flitet vetëm për taksën, të cilën Qeveria e Kosovës ua ka vendosur produkteve serbe. Ai ka thënë se edhe subjektet politike opozitare duhet të bëhen pjesë e këtij samiti. "S'ka samit të Parisit pa qenë bashkë. Berlinin dhe Parisin duhet t'i mbajmë afër. Unë nuk shkoj në Paris që të flas për taksën. Çka është për mua taksë para ulësës për OKB?! Kosova duhet ta kryejë këtë proces dhe ta mbajë ShBA-në afër. Sa për taksë, nuk shkoj. Për Kosovën shkoj kurdo", ka thënë Veseli për mediet.

Dështimin e këtij samiti ditë më parë e kishte paralajmëruar edhe ministri serb i Punëve të Jashtme, Ivica Dačić. Kryediplomati serb kishte deklaruar se ky samit nuk do të mbahej nëse nuk ka shanse që të arrihet një përmirësim i

gjendjes dhe nëse Kosova nuk e heq taksën. "Ne jemi për kompromis, por nëse pala tjetër nuk do, ne nuk do të veprojmë kundër interesave tona shtetërore e kombëtare", kishte thënë Dačić.

Ndërsa njohësit e rrethanave politike në vend presin që Samiti i Parisit të jetë moment kthese në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Derisa nga Samiti i Francës besoi se do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut, përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht e obligueshme", ka thënë për gazetën "Epoka e re" drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të

Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu. Ndërsa analisti tjetër politik, Shkëlzen Maliqi, ka deklaruar se nëse mbahet ky samit, pritet të vendosen bazat për vazhdimin e këtij procesi. "Nuk besoj se Serbia sot është në gjendje të zotohet hapur për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Kjo do të ishte tepër e rrezikshme për udhëheqësinë e saj aktuale. Por, ajo mund të obligohet që në afatin e caktuar, për shembull brenda gjashtë muajve, të organizohet referendumi për ndryshimin e Kushtetutës të Serbisë, të atyre pjesëve që Kosovën e trajtojnë si pjesë të patjetërsueshme të saj. Me këtë peshë e vendimit do të bartet qytetarët e Serbisë, jo te presidenti Vuçiq", ka thënë Maliqi për gazetën

"Epoka e re".

Në fillim të këtij muaji Kosovën e kishin vizituar këshilltarët diplomatikë të presidentit francez dhe kancelares gjermane, të cilët ishin pritur nga liderët institucionalë. Këta të fundit ishin zotuar para delegacionit francez-gjerman se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë pa kushtëzime dhe se tarifat për mallrat serbe duhet të mbeten në fuqi. Po ashtu, ata patën deklaruar se Kosova mbetet e përkushtuar për dialogun që duhet të përfundojë me marrëveshjen paqësore gjithëpërfshirëse, e cila do ta sjellë njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe anëtarësim të Kosovës në Kombet e Bashkuara.

Kosova këtë vit kryeson me tri nisma rajonale

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, të enjten ka pritur në takim ambasadorët e disa prej vendeve anëtare të nismës rajonale të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP).

Republika e Kosovës nga 8 korriku i këtij viti do ta marrë kryesimin e nismës rajonale të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Kjo po ndodh në të njëjtin vit kur Kosova tashmë ka kryesimin me Fondin e Ballkanit Perëndimor (WBF) dhe me Iniciativën Rajonale të Migracionit, Azilit dhe Refugjatëve (MARRI).

Ministri Pacolli ka vlerësuar se SEECP-i gjatë kryesimit të Kosovës do t'i forcojë lidhjet dhe bashkëpunimin midis shteteve

pjesëmarrëse. "Ne jemi të vetëdijshëm se do të ketë vëmendje shtesë ndaj Kosovës dhe rajonit në përgjithësi gjatë kryesimit sonë në SEECP. Unë jam shumë i vetëdijshëm për sfidat që do t'i kemi për shkak të marrëdhënieve të Kosovës me disa nga anëtarët", është shprehur Pacolli, duke shtuar se ideja dhe synimi i Kosovës është që ta përballojë këtë vëmendje në një mënyrë pozitive.

Pacolli ka theksuar se Kosova është e vendosur të prodhojë lajme pozitive jo vetëm për Kosovën, por edhe për rajonin gjatë kryesimit me SEECP. Ai ka bërë me dije se prioritetet e Republikës së Kosovës do të jenë promovimi i kulturës dhe artistëve të rinj si dhe trashëgimia kulturore dhe harmonia fetare.

Vendet anëtare të SEECP janë



Kosova, Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Turqia, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Mali i Zi, Serbia,

Slovenia, Bullgaria, Greqia, Moldavia dhe Rumania. Kryesimi i SEECP-it është njëv-

jeçar dhe kryesinë e radhës e ushtron Kosova duke filluar nga muaji korrik i këtij viti.

Flet për "Epokën e re", Mazllum Baraliu

Reforma zgjedhore nuk mund

Njohësi i proceseve zgjedhore, Mazllum Baraliu, e ka quajtur të drejtë veprimin e shoqërisë civile për ta pezulluar pjesëmarrjen në punën e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor. Ai ka thënë se kjo notë proteste është shenjë alarmuese se Ligji për financimin e subjekteve politike asnjëherë nuk ka arritur ta realizojë synimin e tij. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Baraliu ka shprehur skepticizëm se procesi i reformës zgjedhore mund të përfundojë këtë vit. Ai ka thënë se pa seriozitet politik dhe pa profesionalizëm nuk do të ketë reformë zgjedhore të mirëfilltë këtë vit

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 QERSHOR

"Epoka e re": Z. Baraliu, si e komentoni pezullimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në punën e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor?

Baraliu: Është një shenjë që gjërat nuk shkojnë mirë sikurse edhe në shumë fusha të tjera, veçanërisht në reformën zgjedhore e cila është proklamuar me një marrëveshje politike para 7-8 vjetësh nga tri subjekte politike me formimin e komisioneve parlamentare për ta trajtuar këtë çështje. Në këtë proces është punuar gati dy vjet, me ç'rast janë ndryshuar dhe plotësuar Ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligji për zgjedhjet lokale, sepse ka qenë i nevojshëm ndryshimi i tyre, sidomos i Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, që është konfuz dhe kontradiktor në dispozitat e tij. Mirëpo në mungesë të dëshirës për t'i lënë përfitimet që i ka kjo kastë politike dhe lidhshipi i partive politike, nuk ka pasur vullnet të mjaftueshëm që të pranohet ajo reformë dhe ka ngecur çdo gjë në vend. Prej asaj kohe kemi shumëçka për të dëshiruar në legjislacionin zgjedhor, në përmirësimin e sistemit zgjedhor dhe në procesin zgjedhor. Prandaj, pezullimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në këtë komision e konsideroj veprim adekuat, të drejtë dhe shenjë alarmuese sepse Ligji për financimin e subjekteve politike asnjëherë nuk ka arritur ta realizojë synimin e tij për shkak se nuk janë bërë transparente për opinionin dhe

për medie burimet e financimit as nga jashtë e as nga brenda. Klasa politike nuk është e interesuar të ketë një ligj i cili do të t'i detektonte të gjitha pikat dhe burimet e financimit të subjekteve politike. Si reaksion i kësaj është edhe protesta e shoqërisë civile dhe është me të drejtë bojkotimi i tyre në punën e komisionit përkatës.

"Epoka e re": Mendoni se do ta vazhdojë punën ky komision pa praninë e shoqërisë civile apo do të ketë reflektim nga deputetët?

Baraliu: Në këtë vend, fatkeqësisht, edhe me përgjegjësinë e bashkësisë ndërkombëtare dhe faktorit vendor, shumë herë shoqëria civile nuk është respektuar sa duhet në qoftë se nuk instrumentalizohet. Nëse nuk i përvetësojnë përmes donacioneve dhe përkrahjeve të ndryshme, atëherë shoqëria civile, që është një faktor shumë i rëndësishëm, nuk respektohet. Dhe meqë nuk respektohet në gama të caktuara, atëherë nuk është çudi që edhe kësaj radhe ky komision dhe vetë struktura parlamentare mund të mos e vrasin mendjen dhe të mos shqetësohen nëse janë apo jo të pranishëm përfaqësuesit e shoqërisë civile në punën e këtij komisioni. Roli i shoqërisë civile dhe medieve është i pazëvendësueshëm në një shoqëri e cila pretendon të jetë serioze dhe zhvillimore në kuptimin e arritjes dhe përforcimit të subjektivitetit ndërkombëtar, ashtu siç ka nevojë shtet ynë. Prandaj, do të duhej ta çmonte shumë më shumë rolin, rëndësinë dhe praninë e shoqërisë civile në aktivitetin legjislativ.



të përfundojë këtë vit

"Epoka e re": Me apo pa shoqërinë civile, si e shihni ecurinë e procesit të reformës zgjedhore?

Baraliu: Me këtë klasë politike e cila ka qenë e përkëdhelur në një mënyrë apo në një tjetër për shkaqe të caktuara nga segmente të caktuara të administratës ndërkombëtare, edhe përmes legjislativës elektorale që është në fuqi, pastaj krijimi i pozicioneve të tyre strategjike dhe dobia për t'i pasur ato privilegje, mendoj se është shkaku kryesor që mund të ndikojë që të mos ketë as vullnet politik e as vullnet institucional për reformë zgjedhore esenciale dhe substanciale. Do të doja që të jem i gabuar dhe të mos ndodhë kështu, por bazuar në të gjitha këto vite, nuk kam shpresë që do të ketë mjaft vullnet dhe energji pozitive për ta përmbyllur njëherë e mirë reformën zgjedhore. Reforma do të duhej bërë jo vetëm përmes ndryshim-plotësimit të ligjit dhe bërjes së ligjit të ri për financimin e subjekteve politike por, në radhë të parë, përmes një ligji të ri që është i gatshëm për zgjedhjet e përgjithshme dhe një ligji për zgjedhjet lokale i cili do të duhej të ishte i sublimuar në një kod zgjedhor në të cilin do të rregulloheshin pastaj edhe çështjet e financimit të subjekteve politike dhe ato materie të cilat janë të rregulluara me të ashtuquajturat rregulla zgjedhore të KQZ-së. Është shumë e rëndësishme që në këtë reformë të përfshihen të gjithë, përfshirë këtu shoqërinë civile, botën akademike dhe ekspertët.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh këto zhvillime, sa ka gjasa që para zgjedhjeve të përfundojë reforma?

Baraliu: Në qoftë se do të ketë zgjedhje të parakohshme dhe të gjitha gjasat janë se në vjeshtën e vonë mund të ketë zgjedhje, atëherë nuk ka kohë për reformë zgjedhore. Ky proces nuk është lojë dhe nuk është punë që bëhet për dy-tri javë apo dy-tre muaj. Mirëpo nëse kjo qeveri e çon deri në fund mandatin atëherë ka kohë mjaft që të merret seriozisht puna e reformës zgjedhore. Për mendimin tim, është koha e fundit që të bëhet reforma zgjedhore. Fatkeqësisht, njëra prej shkaqeve të krizës në Shqipëri është pikërisht mungesa e reformimit të sistemit elektorale, respektivisht marrëveshjet e brendshme të disa subjekteve kryesore të cilat kanë vënë bazamentet e një sis-

temi i cili gjithsesi nuk është më i miri dhe iu shkakton probleme partive të vogla. Reforma duhet bërë për të mirën e të gjithëve. Por, para reformës zgjedhore duhet të ndodhë reformimi i partive politike.

"Epoka e re": Mungesa e reformës mund të prodhojë sërish kriza politike në Kosovë?

Baraliu: Patjetër, sepse është një prej pengesave kryesore. Mungesa e kësaj reforme u mundëson partive politike vazhdimin e përfitimit të privilegjeve dhe përfitimeve të ndryshme.

"Epoka e re": Pra, për këtë vit janë shuar shpresat se mund të përfundojë ky proces?

Baraliu: Nëse punohet seriozisht, duke konsultuar

shkencën, duke konsultuar përvojat e sistemeve të vendeve përreth nesh, atëherë mund të ndodhë reforma. Por, duke pasur parasysh këtë gjendje, nuk mund të presim që shpejt e lehtë të bëhet një reformë aq më tepër kur te ne shumë pak respektohen shkenca dhe profesionalizmi. Siç e theksova edhe më herët, reforma e mirëfilltë zgjedhore nuk bëhet për disa muaj apo disa javë. Prandaj, për mendimin tim, pa seriozitet politik dhe institucional si dhe pa profesionalizëm nuk do të ketë reformë zgjedhore këtë vit. Mirëpo mund të ketë improvizime siç dinë t'i bëjnë përfaqësuesit e kësaj klase politike dhe këtyre institucioneve shkel e shko dhe shpejt e lehtë, por jo diçka substanciale që kërkon dije,

kohë, përkushtim dhe patriotizëm ndaj shtetit. Në mungesë të kësaj e kemi këtë gjendje në shtetin tonë. Mirëpo është koha e fundit që të ndryshojë rrënjësisht edhe koncepti, edhe qasja e kësaj klase politike dhe e institucioneve të saj në mënyrë që seriozisht t'i marrin gjërat, ta kuptojnë përgjegjësinë që e kanë dhe jo të merren me vetveten duke krijuar gangrena të caktuara dhe ganglione politike për t'i mbrojtur pozicionet e tyre dhe avazin e vjetër. Nëse vazhdohet me këtë avaz, Kosova u zbrazë dhe kjo klasë politike duhet ta kuptojë se për çdo ditë qytetarët janë gjithnjë e më të pakënaqur dhe se këta do ta kenë gjithnjë e më vështirë nëse nuk ndryshojnë konceptualisht dhe esencialisht.

Ministri Tahiri viziton Komunën e Bujanocit

BUJANOC, 20 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, me ftesë të kryetarit të Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka marrë pjesë sot në ceremoninë e inaugurimit të shkollës fillore në fshatin Samolicë të kësaj komune. Punimet në këtë shkollë janë kryer me mjete të ndara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e dhënë nga ministri Tahiri. Gjatë ceremonisë së inaugurimit, ministri Tahiri ka theksuar se një ndër vizitat e para pas marrjes së mandatit e kishte bërë në këtë komunë, për të ndihmuar në projektet

që drejtpërdrejt ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve të kësaj ane. "Me anë të asaj vizite kam pasur për qëllim që ta vendosi një standard të ri në politikën e Qeverisë së Kosovës, ku kontributi dhe angazhimi për ta lehtësuar dhe përmirësuar jetën e banorëve shqiptarë të Luginës të jetë një interes madhor dhe detyrim politik primar i institucioneve të Kosovës", ka thënë ministri Tahiri.

Ai ka potencuar se çdo investim në Luginë të Preshevës në fushën e arsimit është investim në zhvillimin e këtij rajoni

dhe se Kosova e ka obligim të jetë sa më aktive në këtë drejtim. "E drejta për shkollim dhe arsim është një e drejtë fundamentale demokratike njerëzore. Mirëpo, kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet nëse mungojnë kushtet bazike. Ajo shndërrohet vetëm në një të drejtë formale pa përmbajtje", ka theksuar ministri Tahiri. Ndërsa kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka potencuar se iniciativa e ministrit Tahiri u ka hapur rrugë shumë bashkëpunimeve të tjera me Qeverinë e Kosovës që aktualisht janë duke u realizuar në këtë komunë.



Haradinaj nderon Halil Kastratin me dekoratën "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu"

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka prituri të enjten në takim themeluesin e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati. Duke e quajtur njeri me vlera të mëdha që gjithë angazhimin e tij po ua dedikon njerëzve në nevojë, kryeministri Haradinaj shprehu respektin për punën e tij dhe gjithë organizatës që ai drejton në shërbim të familjeve dhe njerëzve në nevojë. "Qeveria e Kosovës është duke punuar në vazhdimësi që qyte-

tarëve të vendit t'u ofrojë një jetë të dinjitetshme, megjithatë gatishmëria e njerëzve të vullnetit të mirë dhe puna humanitare sikurse e z. Kastrati është gjithmonë e mirëseardhur", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar angazhimin dhe humanitetin e tij për t'u dalë në ndihmë familjeve dhe njerëzve në nevojë.

Haradinaj, po ashtu, shprehu gatishmërinë e qeverisë së vendit për mbështetjen në projektet e kësaj organizate, me theks të veçantë mbështetjen për ndërtimin e një jetimoreje për fëmijët e braktisur. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj në emër të Qeverisë së

Kosovës, në shenjë falënderimi për punën e madhe humanitare, si një vlerë komplementare, ka nderuar me dekoratën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" humanistin dhe themeluesin e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati. Ndërkaq themeluesi i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, u shpreh mirënjohës për pritjen dhe dekoratën e dhënë nga kryeministri Haradinaj, të cilën tha se ua dedikon të gjithë shqiptarëve të vullnetit të mirë, të cilët janë kontribuuesit kryesorë dhe i vetmi burim i financimit të shoqatës brenda dhe jashtë Kosovës.



Zyra Kombëtare e Auditimit, pa vërejtje për Universitetin 'Isa Boletini'

Rektori i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Alush Musaj, ka theksuar se raporti i auditimit që nuk ka dhënë asnjë vërejtje të vetme tregon për profesionalizmin dhe menaxhimin e suksesshëm në këtë institucion. Ndërsa drejtori për Financa në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", Besim Kurti, ka theksuar se procesi i auditimit është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (SNISA)

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

MITROVICË, 20 QERSHOR - Në raportin e publikuar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), si nënprogram i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për financat në vitin 2018, nuk është adresuar asnjë çështje. Auditori gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të prezantuar, bazuar në standardet e aplikuara, ka dhënë opinion të pamodifikuar, me arsyetim se dokumentacioni dhe dosjet e kërkuara janë për gatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtimin me kornizën e zbatueshme financiare.

Rektori i UMIB-it, Alush Musaj, ka theksuar se raporti i

auditimit që nuk ka dhënë asnjë vërejtje të vetme tregon për profesionalizmin dhe menaxhimin e suksesshëm në këtë institucion. Ai ka vlerësuar përkushtimin e stafit përgjegjës, i cili ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë në këtë drejtim. Ndërsa drejtori për Financa në UMIB, Besim Kurti, ka theksuar se procesi i auditimit është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (SNISA). "Sipas këtyre standardeve, është prezantuar dhe kontrolluar dokumentacioni i kërkuar duke dhënë mundësinë e konsultimeve të përgjegjësve që mbulojnë fushat që ishin objekt i kontrollit. Dosjet e kërkuara ishin të mjaftuara që auditori i përgjithshëm të japë opinion



profesional lidhur me menaxhimin financiar", ka thënë Kurti. Sipas tij, procesi i auditimit ishte i bazuar në dokumentet që rregullojnë funksionimin financiar në UMIB.

Në këtë kontekst, objekt i kontrollit ishin planifikimi, menaxhimi, shpenzimet, burimi i të

hyrave dhe kontrolli financiar i aktiviteteve të realizuara në të gjitha kategoritë ekonomike. Gjithashtu, janë audituar rregulloret e aprovuara, kompensimet etj., për të cilat nuk janë gjetur vërejtje.

Vërejtje nuk janë gjetur as për Strategjinë Zhvillimore për Universitetin e Mitrovicës për

vitet 2018-2021, në fushën e buxhetit dhe proceseve të cilat ndërliken me planet strategjike të aprovuara nga MASHT. Kurti ka pohuar se auditori nuk kishte vërejtje dhe komente lidhur me planifikimin, performancën dhe indeksin e realizimit të buxhetit për vitin fiskal 2018.

36 raste janë duke u hetuar për krim të organizuar

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme të enjten është mbajtur takimi i radhës i autoritetit qeveritar për Strategjinë Shtetërore kundër Krimin të Organizuar dhe Planin e Veprimit 2018-2022.

Takimin e hapi koordinatori nacional Kundër Krimin të Organizuar, njehëresh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra. Në

këtë takim u diskutua për aktivitetet që janë ndërmarrë në luftën kundër krimin të organizuar dhe arritjet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës. Zëvendësministri Shkodra ka thënë se do t'i vazhdojnë me përkushtim të shtuar përpjekjet maksimale për luftimin e të gjitha llojeve të krimin në Kosovë dhe të gjithë atë që do të bëjnë shkelje do të përballen me ligjin.

Në këtë takim u raportua se momentalisht janë 36 raste duke u hetuar nga organet e rendit për krim të organizuar, ku të përfshirë janë mbi 200 persona. Ndërsa vetëm në tremujorin e parë të vitit 2019 janë shtuar edhe tri raste me 20 persona. Ministria e Punëve të Brendshme është bartëse kryesore e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Krimin të Organizuar 2018-2022.



Kosova e Turqia nënshkruajnë planin e veprimit për bashkëpunim në shëndetësi

Në prani të ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, plani i veprimit u nënshkrua nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, dr. Naim Bardiqi dhe zëvendësministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë, prof. dr. Emine Alp Mese

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë, bazuar në "Marrëveshjen në mes të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë" të nënshkruar në Ankara më 8 shtator 2009, nënshkruan të enjten në Prishtinë planin e veprimit për bashkëpunim dhe partneritetin në shëndetësi për periudhën 2019-2021.

Në prani të ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, plani i veprimit u nënshkrua nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, dr. Naim Bardiqi dhe zëvendësministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë, prof. dr. Emine Alp Mese. Ministri Ismaili ka thënë se nënshkrimi i këtij plani i jep një shtytje të re bashkëpunimit të mirë në fushën e shëndetësisë midis dy shteteve dhe forcimit të marrëdhënieve të mira që dy shtetet kanë edhe në rrafshet e tjera. Zëvendësministria turke Emine Alp Mese, e cila po qëndron në Kosovë në kohën kur po realizo-

het Java e Shëndetësisë Kosovë - Turqi, ka theksuar rëndësinë e marrëdhënieve të mira tradicionale midis dy shteteve, të cilat kanë ditur të ngrënë marrëdhënie të mira të bashkëpunimit si në ditët e vështira ashtu dhe tani. "Siç e dini, në mes të Kosovës dhe Turqisë në vitin 2009 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë. Në kuadër të fushëveprimit të kësaj marrëveshjeje, për çdo vit nga 100 pacientë nga Kosova që nuk kanë mundur të trajtohen në Kosovë janë trajtuar në spitalet publike të Turqisë falas. Deri më tani, në spitalet publike të Turqisë, sipas kësaj marrëveshjeje, janë trajtuar mbi 800 pacientë nga Kosova", ka thënë zëvendësministria Alp Mese. Ajo ka thënë se plani i veprimit i nënshkruar është një demonstrim i bashkëpunimit të rëndësishëm Kosovë - Turqi në shëndetësi, i cili ka për qëllim t'i forcojë sistemet shëndetësore të dy vendeve, ta nxisë bashkëpunimin në shumë fusha. Zëvendësministria turke ka theksuar edhe faktin se gjatë pesë vjetëve sa është duke u zhvilluar Java e Shëndetësisë Turqi - Kosovë, ekspertët mjekësorë nga Turqia kanë kryer në QKUK dhe spitalet e Kosovës rreth 400



operacione, 1 500 kontrollime dhe analiza mjekësore, derisa 1 300 profesionistëve shëndetësorë të Kosovës u është dhënë mundësia të ndjekin edukim të vazhduar mjekësor në fusha të ndryshme të mjekësisë. Sekretari i përgjithshëm i MSh-së, dr. Naim Bardiqi, duke vlerësuar bashkëpunimin e mirë dhe gatishmërinë e MSh të Turqisë për ta ndihmuar Kosovën për ofrimin e asistencës teknike, har-

timin e një plani për licencimin dhe akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, ka thënë se plani i veprimit adreson në mënyrë të qartë fushat konkrete ku shteti i Turqisë mund ta ndihmojë Kosovën në shëndetësi, si: bashkëpunim në fushën e shëndetit publik, emergjencave mjekësore, në fushën e kontrollit të infeksioneve spitalore dhe të shërbimeve të kujdesit intensiv, në fushën e mjekësisë tradi-

cionale, në krijimin e politikave dhe planifikimin buxhetor bazuar në dëshmi, në aktivitete të akreditimit për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë në shërbimet shëndetësore, në sistemin e vendosjes së çmimit të barnave etj. Ai ka thënë se forcimi i bashkëpunimit në shëndetësi do të krijojë mundësi të reja për përmirësimin e sistemit shëndetësor të Kosovës përmes partneritetit me Turqinë.

Turqia ofron mbështetje për ShSKUK-në

Zëvendësministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë, dr. Emine Alp Mese, në kuadër të zhvillimit të Javës së Shëndetësisë Kosovë - Turqi, ka vizituar sot Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ajo është pritur në takim nga drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, i cili fillimisht e ka njoftuar në lidhje me strukturën dhe organizimin e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Ai e njoftoi se ka ndodhur një riorganizim i tërësishëm në strukturën e ShSKUK, ku është krijuar sektori për kualitet dhe cilësi të shërbimeve shëndetësore, po ashtu ai për donacione dhe bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe për

ndryshime të tjera që kanë qëllim organizimin më të mirë të punës. Duke e falënderuar për ndihmesat e deritanishme, drejtori Sejdiu ka theksuar se ishte i mirëseardhur bashkëpunimi me shtetin turk, sepse ndihma ka ardhur kur ka pasur shumë nevojë. "Ka qenë e mirëseardhur ndihma, sidomos sa i përket edukimit të stafit në shumë profile të ndryshme", ka thënë Sejdiu. Zëvendësministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë, dr. Emine Alp Mese, ka potencuar se Turqia është avancuar mjaft në shëndetësi, ka mjekë mjaft të arsimuar në të gjitha shërbimet. "Jemi të lumtur

që ua ofrojmë pacientëve nga Kosova ndihmën. Jemi të gatshëm t'i ndajmë dijet tona me vëllezërit tanë nga Kosova. Marrëveshja që u nënshkrua sot është në këtë kuadër. I mirëpresim mjekët kosovarë në Turqi", u shpreh ajo. Gjatë takimit u bisedua edhe për mundësinë që mjekët nga Kosova të shkojnë për edukim në Turqi për profile të ndryshme, po ashtu, në raste të tubimeve dhe konferencave profesionale, edhe mjekët nga Turqia të vijnë në Kosovë. Zëvendësministria Mese, pas takimit, ka vizituar Klinikën Infektive dhe Mjekimin Intensiv Qendror, ku është njoftuar me punën që bëhet në këtë klinikë.



Nënshkruhet memorandumi për ndërtimin e rrugës Junik - Gjeravicë

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Ministri i Infrastruktura dhe Transportit, Pal Lekaj, të enjten ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Junikut, Agron Kuçin, përmes të cilit kjo ministri financon ndërtimin e rrugës Junik - Gjeravicë. Shuma e ndarë për

këtë rrugë është katër milionë euro, e paraparë për tre vjet. Me rastin e kësaj marrëveshjeje ministri Lekaj ka theksuar edhe një herë vendosmërinë e tij që Ministria e Infrastruktura dhe Transportit që ai drejton, të implementojë projekte në dobi të qytetarëve

të secilës komunë në Republikën e Kosovës. Ndërsa kryetari Kuçi ka shprehur mirënjohjen e tij dhe të qytetarëve të Junikut për investimet tejet të rëndësishme që Ministria e Infrastruktura dhe Transportit ka drejtuar në komunën e tyre.



Beqaj jep dorëheqje nga posti i ministrit: Drejtësia do ta vërtetojë pafajësinë time

Besim Beqaj ka dhënë dorëheqje nga posti i ministrit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Dorëheqja e tij vjen një ditë pas vendimit të kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, për largim nga detyra të të gjithë anëtarëve të kësaj partie politike që mbajnë poste publike por që, njëkohësisht, janë të akuzuar nën dyshime për korrupsion dhe nepotizëm



themelot dhe funksionalizoj një institucion i cili mbetet i hapur për bashkëpunim ndërkombëtar me partnerët tonë, si dhe bashkëpunim vendor me sektorin privat, shoqërinë civile dhe mediat. Kemi arritur të hartojmë legjislacion dhe politika strategjike për ta vendosur në pah inovacionin dhe ndërmarrësinë; ta ndërtojmë infrastrukturën e nevojshme ku ndërmarrësit e rinj mund ta jetësojnë ëndrrën e tyre për ndërmarrësi dhe inovacion; t'i krijojmë instrumentet financiare përmes fondit të inovacionit, i cili ka përkrahur shumë të rinjtë dhe të reja. Dua t'i falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët brenda dhe jashtë institucioneve që kam udhëhequr, në veçanti juve përfaqësues të mediave për bashkëpunimin e gjatë dhe të suksesshëm që kemi pasur", ka deklaruar Beqaj.

Pavarësisht prej dorëheqjes nga posti i ministrit, Beqaj ka thënë se do të vazhdojë të jetë pjesë e PDK-së pasi, siç ka thënë ai, ka dhënë kontribut të madh në këtë parti.

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka njoftuar të enjten se i ka dorëzuar kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, dorëheqjen e tij nga posti i ministrit. Dorëheqja e Beqajt vjen një ditë pas vendimit të kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, për largim nga detyra të të gjithë anëtarëve të kësaj partie politike që mbajnë poste publike por që, njëkohësisht, janë të akuzuar nën dyshime për korrupsion dhe nepotizëm.

Në një konferencë për media, Beqaj ka thënë se vepra penale për të cilën është duke u gjykuar nuk ka elemente të veprës së korrupsionit. "Si rezultat i diskutimeve të përbashkëta në lidhje me veprimet që duhen ndërmarrë për ta argumentuar vizionin e Partisë Demokratike të Kosovës, ju njoftoj se sot në mëngjes kam paraqitur dorëheqjen time te kryeministri i qeverisë. Fillimisht dëshiroj të reflektoj shkurtimisht

në lidhje me vendimin e Partisë Demokratike të Kosovës. Konsideroj se ky është angazhim i përbashkët i të gjithë strukturave udhëheqëse të PDK-së, pjesë e së cilës jam dhe vetë, që të eliminohen paragjykimet dhe akuzat me pretendime, në lidhje me proceset gjyqësore të zyrtarëve të PDK-së. Në rastin tim, unë jam plotësisht i bindur se këto akuza janë të pabazuara në fakte dhe argumente ligjore dhe që drejtësia do ta vërtetojë këtë. Është parim bazë i drejtësisë që çdokush është i pafajshëm përderisa të mos provohet e kundërta. E ftoj secilin që ta respektoj këtë parim. Unë besoj se drejtësia do ta vërtetojë pafajësinë time duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara. Vepra për të cilën gjykohem: 'Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës', nuk ka asnjë element të veprës së korrupsionit", ka thënë Beqaj, i cili është pjesë e aktakuzës së ngritur për rastin "Pronto", nën dyshimet për veprën penale të "Shkeljes së statutit të barabartë të shtetasve

dhe banorëve të Republikës së Kosovës".

Ai ka theksuar se aktakuza ndaj tij ka një mal të metash. "Që në fillim është aplikuar drejtësi selektive. Për detajet do të flasim në gjykatë dhe ju ftoj ta përcillni me vëmendje të plotë këtë proces dhe mund ta siguroj secilin se në rast të një procesi të drejtë gjyqësor, objektiv, të paanshëm, unë do të lirohem nga aktakuza. Andaj, ky nuk është vendi ku duhet të diskutojmë për përmbajtjen e aktakuzës, por vetëm në gjykatë", është shprehur ai.

Beqaj ka thënë se gjatë angazhimit të tij publik dhe privat është

udhëhequr nga dy parime themelore: zbatim i ligjeve dhe profesionalizimi. "Gjatë mandatit tim në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë kam arritur ta

Beqaj përshëndetet me Haradinajn, kryeministri e falënderon për bashkëpunim

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritë të enjten në takim Besim Beqajn, nga i cili ka pranuar dorëheqjen nga ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Me këtë rast, Haradinaj ka falënderuar Beqajn për bashkëpunimin e deritashëm.

Ligji për financat e pushtetit lokal ka rëndësi të veçantë për funksionimin e komunave



Prishtinë, 20 qershor (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Asociacioni i Komunave, ku është diskutuar për Projektligjin për financat e pushtetit lokal. Hamza gjatë takimit me kryetarët e komunave të Kosovës ka theksuar se Ligji për financat e pushtetit lokal është i një rëndësie të veçantë për funksionimin e pushtetit lokal. Ai ka theksuar se konceptdokumenti për

financat e pushtetit lokal është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2018, ku edhe janë paraparë të bëhen disa ndryshime ligjore.

Gjithashtu, ministri Hamza ka thënë se është shumë me rëndësi krijimi i grantit specifik për shërbime sociale sipas sistemit të hapur të financimit të njëjtë si për arsim dhe për shëndetësi, po ashtu me këtë projektligj parashihet që të definohen më qartë kriteret për ndarjen e

granteve të veçanta. Ai ka shtuar se me këtë rast Qeveria e Kosovës duhet t'i aprovojë udhëzimet administrative të propozuara nga ministritë e linjës. "Si rezultat i bartjes së buxhetit dhe numrit të punëtorëve nga niveli lokal në atë qendror për shërbimet e centralizuara, do të zvogëlohet granti i përgjithshëm nga 10 për qind në 9 për qind dhe ky zvogëlim i grantit do të ketë efekt neutral në buxhetin e komunave", është shprehur ministri Hamza.

Lluka: Hapja e të dhënave, ndihmesë për bizneset

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka marrë pjesë në ngjarjen e organizuar nga "Open Data Kosova", me titullin "Hapja e të Dhënave të Bizneseve dhe Zhvillimi Ekonomik i Kosovës". "Open Data Kosova" ka krijuar platformën "Bizneset e Hapura", ku qëllimi kryesor është të lejohej realizimi i analizave ekonomike për sektorë të ndryshëm dhe aktivitete afariste,

analizimi i trendëve ekonomikë përgjatë periudhave të ndryshme kohore. Gjatë fjalimit në këtë ngjarje, kreu i MZHE-së, Valdrin Lluka, ka thënë se hapja e të dhënave, përveç transparencës, shërben edhe si ndihmesë për bizneset, akademinë dhe organizatat, duke u lehtësuar kryerjen e hulumtimeve dhe analizave të tregut.

Kurse Leonora Kusari, menax-

here kryesore e Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë, ka theksuar se hapja e të dhënave ka bërë përditësimin e të dhënave ekzistente. Ndërkaq drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës, Arian Zeka, ka deklaruar se hapja e të dhënave, përveçse duhet të jetë lehtë e përdorshme, ato duhet të arrijnë dy synime: ndihmën ndaj qeverisë dhe qytetarëve të vendit.



Mbi 60 për qind e qytetarëve në moshë pune nuk janë ekonomikisht aktivë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP). Kjo anketë përfshin tremujorin e parë të vitit 2019. Anketa ka përfshirë gjithsej 4 004 ekonomi familjare që janë përzgjedhur sipas metodës së rastit. Sipas rezultateve të dala nga ky publikim, dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune. Në popullsinë e moshës së punës përfshihen moshat 15-64-vjeçare. Sipas ASK-së, nga popullsia aktive mbi 60 për qind e tyre nuk janë të punësuar, nuk kanë kërkuar punë, por edhe nuk kanë qenë të gatshëm të fillojnë punë. "Në kuadër të popullsisë në moshë të punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është mbi 38 për qind. Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e parë 2019 është mbi 28 për qind. Punësimi më i lartë është te meshkujt 43 për qind, ndërsa punësimi te femrat është mbi 13 për qind. Femrat janë të punësuar, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor me mbi 54 për qind të tyre. Ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit, me mbi 43 për qind", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se sipas tremujorit të parë të AFP-së 2019, në Kosovë ka pasur 125 717 persona të moshës 15-64



vjeç, që ishin të papunë, 88 915 nga të cilët ishin meshkujt dhe 36 802 femra. "Shkalla e papunësisë mbi 26 për qind më e lartë ishte te femrat me mbi 31

për qind sesa te meshkujt, me mbi 25 për qind", ka njoftuar ASK-ja. Papunësia te të rinjtë është shumë e lartë në Kosovë. "Në

tremujorin e parë të vitit 2019, të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Papunësia është më e lartë te femrat e reja mbi 60 për qind se te të rinjtë meshkujt mbi 46 për qind. Pothuaj një e treta, 29 për qind e personave të moshës 15 deri 24-vjeçare në Kosovë, nuk ishin në shkollim, punësim apo trajnim. Kjo shifër është 30 për qind për femrat e reja krahasuar me 27 për qind për të rinjtë meshkujt", është theksuar në raportin e ASK-së.

Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: Tregtia me mbi 16 për

qind, ndërtimtaria me 11 për qind, arsimit me 11 për qind, si dhe prodhimi me 11 për qind. Ndërsa sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim. "Sa iu përket të punësuarve me kontrata, del se janë pak mbi 39 për qind e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 60.90 për qind kanë kontratë të përkohshme. Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 300 euro deri 400 euro në muaj. Janë vërejtur dallime gjinore me 6.5 për qind më e lartë te femrat sesa te meshkujt", është thënë në raportin e ASK-së.

Haradinaj: Papunësia në Kosovë është ulur në 26.9 për qind

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se, bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në Kosovë është ulur në 26.9 për qind në periudhën janar-mars të këtij viti në krahasim me 31.6 për qind sa ka qenë në periudhën tetor-dhjetor të një viti më parë.

Haradinaj ka konsideruar se këto të dhëna përbëjnë lajm të mirë dhe janë dëshmi e zhvillimit të brendshëm ekonomik. "Bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në Kosovë është ulur në 26.9 për qind për periud-



hën janar-mars 2019 në krahasim me periudhën tetor-dhjetor 2018 që ishte 31.6 për qind. Këto statistika tregojnë edhe një fakt, që ulja e papunësisë ka ndodhur në

grupmoshat 15-54-vjeçare. Nga 57.3 për qind të të papunëve nga kjo grupmoshë, tremujori i parë i 2019-s tregon një ulje për 7 për qind, konkretisht 50.6 për qind",

ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se këto statistika janë lajm i mirë për të gjithë qytetarët dhe dëshmi e zhvillimit të brendshëm ekonomik. "Megjithëse për qeverinë e vendit mbetet shqetësim i vazhdueshëm shkalla e papunësisë në vend, në këtë përpjekje do ta vazhdojmë angazhimin tonë për ta fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, duke mbështetur prodhuesit tanë dhe duke tërhequr investime të huaja të drejtpërdrejta, të cilat çojnë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e përgjithshme ekonomike", ka deklaruar Haradinaj.

Zvicra ratifikoi marrëveshjen për sigurime sociale me Kosovën

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, ia ka dorëzuar ministrin të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçicës, notën verbale mbi ratifikimin e marrëveshjes historike për sigurimet sociale në mes të Kosovës dhe Zvicrës, marrëveshje kjo e cila tashmë është ratifikuar edhe nga shteti zviceran.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka theksuar se ky është një lajm i rëndësishëm për të gjithë qytetarët dhe shtetin e Kosovës. "Me ratifikimin e kësaj marrëveshje më në fund triumfoi e drejta e qytetarëve për të ripërfitur nga pensionet dhe përfitimet, e drejtë e cila iu mohua me vite të tëra shumë bashkëkombësve tanë të cilët për vite të tëra kanë

derdhur djersën e tyre me kontributin e dhënë për shtetin zviceran dhe për mbijetesën e familjeve të tyre në Kosovë. Falënderojmë të gjithë bashkëpunëtorët tanë për realizimin e kësaj marrëveshje. Gjithashtu, një falënderim të veçantë edhe për shtetin tonë mik, Zvicrën, e cila ka shprehur gatishmërinë që ta zgjidhim njëherë e mirë çështjen e sigurimeve sociale, e cila do të hapë rrugë për nënshkrimin e marrëveshjeve të tilla edhe me shtete të tjera", është thënë në njoftimin e MPMS-së.

Qytetarët do të njoftohen së shpejti nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me këtë marrëveshje dhe të gjitha procedurat për aplikim dhe realizim të të drejtave të tyre.



Shtatë familjeve skamnore në Skenderaj do t'u ndërtohen shtëpitë e reja

SKENDERAJ, 20 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe humanisti Halil Kastrati nga Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", kanë vizituar familjet nga fshatrat e kësaj komune të cilat janë përzgjedhur nga komisioni komunal për çështje sociale, për ndërtim të shtëpive. Familjet që janë përzgjedhur për shtëpi janë: Jashar Miftari - Runik, Tafil Abdullahu - Çitak, Gani Dervishi - Kosterc, Hajriz Hyseni e Astrit Krasniqi - Vajnik,

si dhe Shefqet Sahiti e Behxhet Shala - Koliq i Poshtëm, të cilave gjatë vizitës u është kumtuar lajmi për ndërtimin e shtëpive të reja. Me këtë rast, kryetari Jashari ka thënë se kjo po bëhet falë bashkëpunimit të shkëlqyer në mes të komunës dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", me një bashkëfinancim të projektit të përbashkët fisnik dhe human për t'u bërë zgjidhje për banim familjeve të cilat jetojnë në kushte shumë të vështira. "Me humanistin Halil Kastratin nga

Shoqata 'Jetimat e Ballkanit' kemi të nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancim në ndërtimin e 25 shtëpive për familjet që kanë gjendje jo të mirë ekonomike. Në emër të familjeve përfituese, të gjithë qytetarëve tanë dhe komunës, falënderoj hoxhë Halil Kastratin për këtë bashkëpunim të jashtëzakonshëm, nëpërmjet të cilit po u kthehet buzëqeshja familjeve në nevojë. Lajmet dhe veprimet e mira nuk mbarojnë këtu!", ka thënë Jashari.



Mbahet pjesa e dytë e provimit të maturës në regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit

FERIZAJ, 20 QERSHOR (ER) - Provimi i Maturës Shtetërore 2019 (pjesa e dytë e afatit të parë) është mbajtur të enjten në regjionin e Ferizajt dhe të Gjilanit dhe, sipas raporteve të ardhura nga terreni dhe të analizuar nga Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM), në përgjithësi testi ka shkuar mirë dhe nuk ka pasur parregullsi të mëdha të cilat do ta dëmtonin procesin. Në bazë të raporteve të pranuar nga dy regionet, të cilat

sot kanë organizuar Testin e Maturës, gjatë kësaj dite, për shkak të mospërfilljes së rregullave, janë përjashtuar nga procesi 40 nxënës. Një nga këta nxënës e ka sulmuar fizikisht një administrues në qendrën e testimit në shkollën "Mehmet Akif" në Lipjan dhe ky rast është hapur në polici. Po gjatë ditës së sotme, ndaj një administruesi në qendrën nr. 12 në Ferizaj, është hapur procedurë disiplinore. KShM falënderon të gjithë

aktorët e përfshirë në proces për përgatitjet e duhura për këtë provim shtetëror dhe për nivelin e lartë të përgjegjësisë që e kanë treguar gjatë kohës sa është mbajtur provimi. Ndërsa KQShM u bënë thirrje organeve të rendit dhe prokurorisë që të marrin masa ndaj atyre që përpiqen t'i keqpërdorin rrjetet sociale, apo formojnë grupe në "viber", me qëllim të komunikimit gjatë mbajtjes së testit.

Fillon turneu i takimeve me të rinjtë nëpër Kosovë

SHTIME, 20 QERSHOR (ER) - Nën organizimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka filluar turneu i takimeve me të rinjtë nëpër tërë Kosovën, me moton "Rinia është shpresë për vendin". Ky turne filloi në takimin me të rinjtë në Shtime, ku mori pjesë edhe ministri Kujtim Gashi. Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se kanë filluar turneun e takimeve me të rinjtë tanë, për t'i konsultuar ata për të gjitha programet dhe projektet rinore, por edhe për tema të tjera që shqetësojnë si shoqërinë, duke filluar nga shkollimi, punësimi, luftimi i dukurive negative, roli në vendimmarrje e deri tek arsyet e

largimit të të rinjve nga vendi ynë. "Ishte pajtim i përbashkët se themelimi i Fondit Rinor ka ndikuar dukshëm në mbështetjen e të rinjve dhe organizatave rinore të cilat kanë përfituar në fushat e pjesëmarrjes, edukimit, shëndetit, sigurisë njerëzore, punësimit, sportit, kulturës dhe rekreacionit", ka thënë Gashi. Ai ka shtuar se duke shfrytëzuar Fondin Rinor si program i veçantë, i themeluar për t'i mbështetur të rinjtë tanë, përfitimet do të jenë në rend të parë të ta. Ministri Gashi ka inkurajuar ata të punojnë dhe të angazhohen sa më shumë, e në këtë mënyrë suksesi nuk do t'u mungojë asnjëherë.



Klubi i Prodhuesve kundër rregullores së Kuvendit Komunal në Ferizaj që e diela për bizneset të jetë pushim

FERIZAJ, 20 QERSHOR (ER) - Klubi i Prodhuesve i Kosovës (KPK) ka reaguar kundër propozimit të Kuvendit Komunal në Ferizaj për miratimin e Rregullores Komunale për përcaktimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive të tjera në Komunën e Ferizajt, ku me anë të kësaj rregullore përfshihen të gjitha llojet e veprimtarive dhe përcaktohet orari i punës së tyre, duke vendosur që dita e diel të jetë pushim. "Propozimi për të miratuar një rregullore të tillë nuk është aspak i mirëpritur nga bizneset që operojnë edhe të dielave,

pasi ky vendim në radhë të parë është në kundërshtim me Ligjin e punës që ushtrohet në Republikën e Kosovës. Po ashtu, kjo rregullore shkakton humbje të mëdha për bizneset, që do të reflektohen në uljen e kapaciteteve të prodhimit dhe, rrjedhimisht, të ndikojnë në vendet e punës për këta punëtorë", është thënë në reagimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës. Sipas KPK-së, kjo rregullore do të ketë vetëm efekte negative dhe vështirëson klimën e të bërit biznes në vendin tonë, ku së pari do të preken investimet kapitale dhe do të krijohet

reziku që investitorët të mos e shohin qytetin e Ferizajt si të favorshëm për investim, pasi ulet niveli i qarkullimit buxhetor dhe vëmendja mund të shkojë te shtetet fqinje. "Prandaj, para marrjes së vendimeve të tilla, është mirë që paraprakisht të konsultohet edhe sektori privat, ku do të merren parasysh edhe kërkesat e tij, kur dihet që rritja dhe zhvillimi i sektorit privat është një nga komponentët esenciale për zhvillimin e gjithëmbarshtëm socio-ekonomik të vendit tonë", është theksuar në reagimin e KPK-së.



KUR DO TË KETË AKUZA PËR GJENOCID NË KOSOVË?



Bardhyl MAHMUTI

Në shkrimin e parë, të serisë së shkrimeve që kam publikuar rreth domosdoshmërisë së harmonizimit të terminologjisë lidhur me krimet që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë, kam theksuar se përdorimi i shprehjes "Krimet e luftës në Kosovë" është i mangët për arsye se përmend vetëm një kategori krimesh dhe nuk përfshin gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit.

Kohët e fundit kemi pasur njoftime nga ana e Prokurorisë Speciale për arrestimin e X-it apo Y-it si të dyshuar për krime luftime në Kosovë. Duke u bazuar në fakte të shumta, të cilat janë trajtuar më gjerësisht në librin "Mashtrimi i madh", dëshmohet se gjatë luftës në Kosovë ka ndodhur gjenocid. Qëllimi i vrasjeve, i dhunës seksuale dhe i dëbimit të popullsisë gjatë poli-

tikës së spastrimit etnik, ka qenë shkatërrimi i tërësishëm ose i pjesshëm i shqiptarëve si grup kombëtar, etnik dhe fetar i ndryshëm nga serbët.

Kur kemi të bëjmë me përgjegjësitë lidhur me krimin e gjenocidit, Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit krijon obligime të ndryshme për individët dhe për shtetet.

Gjenocidi, nxitja e drejtpërdrejtë dhe publike për ta kryer krimin, përpjekja për ta kryer krimin dhe bashkëpunimi në krim janë akte që e ndëshkojnë individin në përputhje me të Drejtën Penale Ndërkombëtare të përkufizuar në nenin IV të konventës së lartpërmendur. Edhe në statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, në nenin 25, përcaktohet përgjegjësia individuale kur personi "kryen një krim të tillë, qoftë si individ apo bashkëpunim me një tjetër ose me anë të një personi tjetër, pa marrë parasysh nëse personi tjetër është përgjegjës penalisht apo jo; urdhëron, kërkon apo nxit kryerjen e një krimi të tillë, i cili, në fakt, ndodh apo mbetet në tentativë; ndihmon, përkrah, kontribuon, është në dijeni dhe nuk e pengon kryerjen e krimin etj." (Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, neni 25).

Në përputhje me dokumentin zyrtar të Asamblesë së Shteteve Anëtare të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare të titulluar "Elemente të krimeve" dhe të cituar në disa shkrime paraprake, edhe në rastet kur kemi një vrasje, një dhunim seksual, një dëbim në kuadër të politikës së spastrimit etnik, me qëllim që të shkatërrohen, në tërësi ose pjesërisht, shqiptarët si grup kombëtar, etnik ose fetar kemi akt të gjenocidit. Kjo na mundëson të bëjmë dallimin mes një akti të gjenocidit, kur kemi vdekjen qoftë edhe të një individi të grupit nga gjenocidi apo kur kemi vdekje në një masë më të madhe njerëzish. Mbi këtë bazë të së drejtës penale ndërkombëtare, Prokuroria Speciale e Kosovës mund të bëjë padi kundër individëve, të cilët konstatohet se kanë marrë pjesë në gjenocidin ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Përveç përgjegjësisë individuale, çdo akt i gjenocidit që kryhet nga organet shtetërore, personat ose grupet e personave, veprimi juridik i të cilëve i atribuohet shtetit, e bën përgjegjës shtetin, sepse shtetet kanë nënshkruar dhe kanë miratuar Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit (neni IX i kësaj konvente).

Në këtë mënyrë, shteti përkatës ka shkelur obligimet ndërkombëtare, sepse termi "parandalim" dhe "dënim" nënkuptojnë obligimet për shtetet që të mos kryejnë gjenocid apo cilindo nga aktet e numëruara në nenin III të konventës.

Po marr si shembull rastin e padisë që Bosnjë-Hercegovina bëri kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Serbia "shpëtoi" nga akuza për gjenocid, për arsye se "pala akuzuese nuk arriti të dëshmojë se masakra e Srebrenicës ishte kryer me urdhër dhe direktiva të Serbisë, dhe nuk e dëshmoi që Serbia kishte kontroll efektiv të operacioneve, gjatë së cilave janë kryer këto masakra, që janë pjesë e krimin të gjenocidit në fjalë". (Cour Internationale de justice, Recueils des Arrêts, Avis consultatifs et ordonnances, Affaire relative à l'application de la Convention pour la Prévention et la Répression du Crime du Génocide, Bosnie-Herzégovine contre la Serbie - et - Monté Negro, Arrêtu du 26 Février 2007, paragrafi 413).

Në rastin e Kosovës gjërat janë shumë të qarta: të gjitha operacionet kanë qenë të përpiluara dhe të ekzekutuara nën kontrollin e plotë të komandës shtetërore.

Pa dashur ta rëndoj shkrimin, po kufizohem vetëm në atë, që përgjegjësia e shtetit në gjenocid është e dyfishtë: përgjegjësi penale dhe përgjegjësi civile.

Sa i përket përgjegjësisë penale të shtetit në krimin e gjenocidit, duhet të theksojmë se këtu kemi të bëjmë me një entitet juridik, që ka karakter abstrakt dhe, si i tillë, nuk mund t'u nënshtrohet sanksioneve penale ("nuk mund të burgoset shteti" - është shprehje që përdoret shpesh në këtë kontekst). Megjithatë, ngarkimi me përgjegjësi penale për kryerjen e gjenocidit ka peshë të madhe për imazhin e shtetit dhe e vë përballë një numri masash që mund të ndërmerren kundër tij.

Shteti i Serbisë ka përgjegjësi penale dhe civile për gjenocidin kundër shqiptarëve në Kosovë dhe një ditë do të duhet të japë llogari. Shfrytëzimi i jurisprudencës së Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ruandën dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë na mundëson të integrojmë disa aspekte të reja të së drejtës penale ndërkombëtare, me qëllim që padija të jetë sa më e argumentuar. Duhet të punojmë shumë që gjenocidi i shtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës të njihet në përmasa ndërkombëtare.

Koordinatori i Komitetit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO prezanton kornizën e komunikimit strategjik

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Zyra e Koordinatorit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO, në bashkëpunim me Ekipin Këshillues e Monitorues për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (NALT), si dhe Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mbajti të enjten takim informues për prezantimin e Kornizës së Komunikimit Strategjik për personelin e zyrave të informimit nga ministritë që janë pjesë e Komitetit Ndërministror.

Në takim projektin e ri e prezantuan sipas përgjegjësisë: zëvendësministri i Mbrojtjes, njëherësh edhe koordinatori i Komitetit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim të Kosovës në NATO, Burim Ramadani, Donjeta Gashi, drejtoreshë e Zyrës për Komunikim me Publikun e Kryeministrit si dhe këshilltarja për



Komunikim Strategjik në NALT, për Ministrinë e Mbrojtjes, Nicolien Wellen. Me këtë rast, zëvendësministri Ramadani i njoftoi zyrtarët mbi nevojën e komunikimit me audiencën vendore dhe ndërkombëtare; me të njëjtat porosi mbi punën, progresin dhe synimin e Kosovës, drejt

arritjes së qëllimit për anëtarësim në NATO.

Koordinatori Ramadani ka kërkuar angazhimin e ministritë, anëtar të Komitetit që të angazhohen në përplotësimin nga fushëveprimtaria e së cilës ministri, të draftkornizës së Komunikimit Strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes, që kjo

draftkornizë të jetë edhe Kornizë e Komunikimit Strategjik të Komitetit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim të Kosovës në Aleancën Veri-Atlantike.

Gjithashtu, edhe Donjeta Gashi dhe Nikcolien Wellen, si dhe audiencia e pranishme me diskutime, shprehën nevojën

për një koordinim të mirë të të gjitha dikastereve të përfshira në përplotësimin dhe përfundimin e një kornize të komunikimit strategjik që do ta unifikonte komunikimin me audiencën në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe marrëdhënieve me jashtë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Një program për qeverisje të mirë ose një program përtej partive politike



Jakup KRASNIQI

Ka kohë që në jetën politike, publike dhe mediatike në Kosovë flitet për zgjedhje të reja, ndonëse nga zgjedhjet e kaluara ka kaluar pak më shumë se një vit. Edhe gjatë legjislaturës së kaluar në fillim të saj kishte kërkesa për zgjedhje të reja, ndonëse vendi qeverisje nga një koalicion goxha i madh. Pas tre vjetësh qeverisjeje, me mocionin e partisë më të vogël, të Nismës, Kuvendi e rrezoi qeverinë "Mustafa". Pas këtij votimi shkuam në zgjedhje dhe zgjedhjet nuk krijuan asnjë ndryshim, përkundrazi. Të gjitha problemet që ishin grumbulluar në atë legjislaturë, veç demarkacionit (edhe ai u zgjidh ashtu siç ishte), për qytetarët nuk ndryshoi asgjë, përkundrazi, gjendja u përkeqësua. Në një situatë të tillë zgjedhjet nuk janë zgjidhje. Kosova dhe qytetarët kanë nevojë për ndryshim kualitativ në qeverisje dhe në menaxhimin e parasë e të pasurisë publike. Kosova ka nevojë për një program të qartë qeverisës, që nuk është vetëm i një partie politike, por një program politik dhe ekonomik, që mbyll epokën e keq-qeverisjes dhe fillon mirë-qeverisjen, për t'u ofruar qytetarëve perspektivën që u mungon.

Një gjë duhet të dimë mirë të gjithë në politikë e jashtë saj, se gjatë gjithë viteve të organizimit politik shumë-partiak në Kosovë, që nga fillimi i viteve '90 të shekullit të kaluar, si dhe me këto të shekullit të ri po dëshmojnë katërcipërisht, se në të gjitha partitë politike të quajtura "demokratike", për asnjë temë politike me interes kombëtar nuk ka pasur dhe nuk ka debat të mirëfillt politik. Fjala është për një debat politik përmbytësor të nxitur apo të inkurajuar nga krerët e partive politike, që nuk ka pasur dhe nuk ka as sot brenda përbrenda një partie politike e mos të flasim në rrafshin kombëtar, aty ku partitë politike karakterizohen nga padurueshmëria e komunikimit me përgjegjësi e kulturë. Duhet të themi se në Partinë Demokratike të Kosovës ka pasur debat politik për tema të ndryshme me interes kombëtar deri në zgjedhjet e vitit 2007, i cili në njëfarë mase ka vazhduar deri në zgjedhjet e vitit 2010, më pas i gjithë pushteti është përqendruar te kryetari i partisë (kryeministri). Më pas, "debati" ka qenë vullneti i kryetarit, kurse të tjerët është dashur të mendojnë si ai ose të ecin në rrugën e tyre. Kuptohet, nuk është aspak e lehtë: duhet të kesh vendosmëri të madhe që të shkëputesh nga një parti politike që ke investuar shumë, kur shefi i saj është kryeministër i vendit. Në një rast të tillë është mrekulli të mbi-jetosh politikisht, kur një armatë mediatike të anatemon në shumë

anë. Atmosfera politike e krijuar në Kosovë është atmosferë mbyltese për demokracinë e njëmendtë. Mungesa e një debati me përmbytje në jetën politike dhe mostolerimi i ideve konkurrenente në çdo segment të shoqërisë sonë ka penguar shumë nxjerrjen në dritë të vlerave të njëmendta kombëtare, demokratike, njerëzore dhe intelektuale. Nuk ka asnjë dyshim, se kjo frymë mbyltese e debatit nuk është pasojë e njerëzve të virtytshëm, por e njerëzve me fuqi financiare e muskulore. Kudo ku mungojnë vlerat e virtytshme, ndodh ajo që ndodh me ferrat që dalin në tokat djerrinë, në politikën pa debat e kështu lindin antivlerat e çdo lloji. Dëshmi më e mirë për këtë është sulmi frontal mbi të vetmen vlerë që populli ynë krijoi gjatë shekullit të robërisë dhe e cila kulmoi me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, që solli lirinë e pavarësinë e vendit. Prej 20 vjetësh kësaj vlere i janë vërsulur langonj e çakej, që ta shqyjnë nga të gjitha anët. Muskujt dhe lakmia babëzitive e disa njerëzve gjatë viteve të lirisë e të Pavarësisë, ka bërë që në njëzetvjetorin e lirisë të shkojmë me vlerën kryesore të kombit të përmbytur kokëposht! Dhe jo vetëm kaq, por është shumë e dhimbshme, për faktin se nuk po bëhet asnjë përpjekje serioze për të parë: se ku është gabuar, sa është gabuar dhe pse është gabuar?! Pasi "të pagabueshmë" nuk janë të interesuar të shohin as edhe një gabim. Është krejt e natyrshme se, pa e parë pa syze se ku është gabuar, në qeverisjen e vendit gjatë viteve të shkuara, sidomos pas pavarësisë, në shoqërinë tonë do të vazhdojnë të riciklohen vetëm ato "parti" e shefa që janë ricikluar në pushtet gjatë këtyre viteve të lirisë e të pavarësisë. Do të riciklohen vetëm ata e ato "parti", që kanë kontribuar në krijimin e kësaj paperspektive për kombin e rininë tonë plot energji e dashuri për vendin e kombin.

Çfarë duhet të bëjmë që të nisim një fillim të ri?

I Në një situatë të tillë, gjëja e parë që duhet bërë është që të konstatohet kriza e përgjithshme politike e institucionale, si dhe kriza e thellë në kulturën e komunikimit, e cila pashmangshëm na çon deri aty, sa të mos të merremi vesh për asgjë dhe për asnjë çështje vitale të interesit kombëtar, veçse për kusarinë mbi parane publike e pasurinë nacionale. Këtu gjendet lehtë gjuha e përbashkët. Kështu ishte në qeverisjet e kaluara, kështu është edhe tani. Vrapit që po bëhet edhe sot për pozitën e kryeministrit, nuk jep shpresa se nesër do të kemi ndryshimin që i duhet vendit. Prandaj për shoqërinë shqiptare në përgjithësi e këtë në veçanti, është i domosdoshëm fillimi i një debati për të arritur konsensusin e domosdoshëm për çështjet e domosdoshme të interesit kombëtar. Tani për tani, për Kosovën e qytetarët e saj nuk ka interes më të madh sesa qeverisja e mirë e vendit. Edhe kështu si

jemi, do të ecim disi, do të mbijetojmë disi, por si? Një fjalë e urtë thotë: "Edhe miza nën shalët e kalit e bën një jetë", por çfarë jete është ajo, kur ajo është gjithmonë e rrezikuar nga bishti i kalit që godet si kamxhik!

II Çështja e dytë, e cila nuk është më pak e rëndësishme se e para, është kriza e thellë në sistemin e arsimit publik e privat. Me politikën e deritashme shkatërruese (të universiteteve të pafrë publike e private), sidomos në arsimin e lartë, kriza e mjerimi intelektual veç do të thellohet. Tani për tani nuk ka vullnet politik për të zgjidhur këtë çështje, ndër më vitalët për kombin dhe shtetin. Edhe për të zgjidhur këtë çështje duhet vullnet politik të nivelit kombëtar. Ky vullnet deri më tani nuk ekziston. Ky sistem i arsimit prodhon pak dije e shumë analfabet funksional. Gjuha shqipe është në degradim të përgjithshëm si në të folur, ashtu edhe në të shkruar. Vazhdimi në këtë rrugë do të sjellë një rezultat, që do të jetë edhe më i mjerë sesa është! Ndërprerja e kësaj praktike të deritashme është më shumë se e domosdoshme. E ripërsëris, për këtë është i domosdoshëm konsensusi nacional, pasi nuk ka çështje më kombëtare se arsimi dhe edukimi i kombit, nga i cili varet shumë e ardhmja e kombit dhe e vendit tonë. Arsimi dhe edukimi nuk është dhe nuk mund të jetë çështje e një partie politike, por është kryekrejt interes kombëtar. Prandaj edhe qasja duhet të jetë vetëm në këtë frymë. Ky sistem, i cili ngjason vetëm me kullat e rërës, nuk mund të prodhojë njerëz të virtytshëm, me dinjitet e me integritet! Prandaj i takon këtij brezi, që ta bëjë gjënë e duhur për shpëtimin e kombit.

III Çështja e tretë dhe jo pa qëllim e paraqita si çështje të tretë, janë zhvillimi ekonomik dhe menaxhimi i pasurisë dhe i parasë publike. E bëra këtë, për të treguar se pa arsim të reformuar mirë, për t'i dhënë formë e përmbytje të re cilësore, nuk do të ketë as zhvillim e progres. Gjatë gjithë këtyre viteve e kemi parë se qeveritë, secila në mënyrën e vet, e ka keqpërdorur parane publike dhe pasurinë kombëtare vetëm aty ku grabitja ka qenë më e lehtë dhe më e madhe, por jo aty ku interesi i kombit ishte më i madh. Gjatë gjithë këtyre viteve, qeveritë tona nuk kanë pasur strategji të zhvillimit ekonomik, nuk e kanë as sot, por kanë ecur e po ecin si somnambul, sipas stilit: "Kur rasha mos u vrafsha". Në vitin 1981 shpërthyen demonstratat studentore, se regjimi i Beogradit po shfrytëzonte pasuritë tokësore e nëntokësore të Kosovës. Për shfrytëzimin e pasurisë së Kosovës shkruanin edhe gazeta të ndryshme botërore, ashtu siç shkruanin edhe për varfërinë e popullit të Kosovës. Që njëzet vjet, Kosova është e lirë, e që dhjetë vjet Shteti i Pavarur, po ende nuk jemi duke parë, se pasuritë e Kosovës po shfrytëzohen për të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Kjo është tepër e dhimbshme. Është e dhimbshme se rinia e Kosovës nuk po e sheh perspektivën në atdheun e vet, por duke ikur nga Kosova. Që 20 vjet nuk është investuar në pasurinë kapitale që ka Kosova, siç është energjëtika, Trepça etj. Aty ku të gjitha mundësitë ishin të sheshta, e në të njëjtën kohë, milionat u derdhën për largimin e hirit të viteve të shkuara. Pra, milionat i rëmbeu hiri e errësira dhe asnjë drita e zhvillimi. Populli i Kosovës, toka e Kosovës është në pritje të njerëzve të virtytshëm, që dinë dhe duan të qeverisin e të zhvillojnë vendin.

IV Çështja e katërt, që nuk është më pak e dhimbshme se çështjet e cekura më lart, është çështja e shëndetit publik. Vendi ynë ka mjekë të suksesshëm, që ushtrojnë profesionin e tyre në Evropë e Amerikë, ndërsa mjekësia te ne lë shumë për të dëshiruar. Kosova në vend që të investonte për ndërtimin e një shërbimi shëndetësor modern publik, po shpenzon shuma marramendëse për t'i shëruar qytetarët jashtë vendit. Mjekësia jonë publike në vend që të modernizohet për t'i shërbyer publikut të gjerë po i fal hapësirë mjekësisë private, e cila është bërë zvatësi kryesor i qytetarëve hallexhinj, që do të duhej t'u shërbente shëndetësisë publike! Natyrisht, që kjo nuk bëhet pa interesa kriminale të "filanit e të fistekut". Kosova, si gjeografi e popullsi është e vogël e varfër për të mbajtur mjekë të pasur të figurave me emra të mëdhenj! E sidomos për të mbajtur kaq shumë ordinanca private, të cilat kanë si qëllim kryesor fitimin nga qytetarët e varfër. Pse ka kaq shumë degradim e rrenim në çdo segment publik e kombëtar?

V Çështja e pestë është planifikimi hapësinor dhe mjedisi i pastër. Për të dyja çështjet vendi ynë është në gjendje të mjerë dhe nuk kanë ndonjë perspektivë zhvillimi. Hapësira jonë jo vetëm që është pa plane, por ka një degradim të përmasave të mëdha, që mjedisin tonë e ka bërë të pistë. Ngado që shkon, ky degradim është më shumë se prezent. As mjedisi jetësor nuk është për një shëndet të mirëqenë.

VI Çështja e gjashtë, por nder më të rëndësishmet është - Sistemi i Drejtësisë i cili jo vetëm që është i pa reformuar, por është edhe krejt jo funksional e jo efikas. Ky sistem i cili për shumë vite, që nga fillimi ka qenë i varur shumë nga ndërkombearet, është mbikëqyruar nga ata e deri para pak kohe ka qenë i mbikëqyruar shumë nga trupa evropiane e quajtur EULX, që kishte kompetenca ekzekutive, por që vazhdon të jetë i paafte për të ndihmuar në ndërtimin e shtetit të së drejtës. Nuk ka shtet të së drejtës aty ku ligjet janë të pazbatueshëm, aty ku njerëzit nuk janë të barabartë para ligjit, aty ku nuk luftohet e ndëshkohet krimi e korrupsioni. Pas pavarësisë është

folur shumë për një reformim të këtij sistemi, por gjithçka tjetër mund të jetë parë, vetëm jo reformim që i duhet vendit tonë. Më këtë përbërje dhe praktikë "funksionimi" ky sistem e ka të vështirë, mbase të pamundur që të bëhet funksional dhe efikas! Ky sistem do të jetë i tillë derisa nuk ka vullnet politik për sundimin e rendit e të ligjit!

Përfundime

Këto gjashtë çështje që u renditën më lart, në fakt janë dëshmi të pakontestueshme se të gjitha qeveritë e deritashme kanë dështuar në qeverisjen e vendit. Kjo që u tha, mbase jo vetëm kjo, dëshmojnë se vendi ynë gjatë gjithë këtyre viteve nuk ka pasur asnjë kryeministër të vetëm që di e do të qeverisë këtë vend dhe pasuritë e qytetarët e tij. Madje, këta njerëz jo vetëm që nuk kanë ditur të qeverisin, por nuk dinë as të komunikojnë me edukatë si njerëz me përgjegjësi të larta shtetërore. Edhe ky fakt tregon se arsimi dhe edukimi ynë është nën çdo nivel.

E gjithë çështja është: si të kemi kryeqeveritar (kryeministër), që di të qeverisë si duhet këtë vend të pasur me qytetarë të varfër! Vrapit për zgjedhje "për të ndërruar kuajt e qerres së kusarëve", janë zgjedhje kot së koti! Vendi dhe kombit tonë i duhet një program i qartësuar mirë, përtej një partie a individi dhe një kabinet qeveritar që di e do të qeverisë mirë, që ka dhe merr përgjegjësi për të qeverisur vendin e kombin. Natyrisht që kjo nuk mund të bëhet pa një program qeveritar për qeverisjen e vendit në mundësitë e parametrat që ka vendi dhe kombi. Asnjë parti politike veç e veç dhe asnjë lider politik sot, nuk i ka kapacitetet politike, intelektuale e profesionale për të hartuar një program të mirëfilltë qeverisës, që i duhet vendit dhe qytetarëve tanë.

Liderët e partive të mëdha politike që kemi sot, duke parë kulturën e tyre të komunikimit, gjuhën që përdorin në komunikim me liderët e partive të tjera politike, e sidomos qëllimet e tyre që, më çdo kusht e mjet, të marrin postin e kryeministrit, pa një përgatitje serioze për të krijuar parametra të duhur për një qeverisje të mirë, janë shenja të dukshme se fjala nuk është për të qeverisur mirë, por për të vazhduar të njëjtën mënyrë të qeverisuri.

Si përfundim, derisa është kjo frymë politike, e cila nuk premtton ndryshim thelbësor në qeverisjen e vendit, nuk ka asnjë arsye të vetme të shkohet në zgjedhje të reja, të parakohshme a të jashtëzakonshme, përkundrazi, sa për të bërë një "ndryshim" të pashpresë në qeveri dhe për të shpenzuar mjete të mëdha financiare nga buxheti i Kosovës për zgjedhje të parakohshme, më mirë është që zgjedhjet të bëhen në afatin ligjor. Mbase mund të bëhen përgatitje më të mira e shpresëdhënëse! Tani për tani nuk shoh se do të kemi një zgjedhje fatlume, edhe po të shkohet në zgjedhje pa "zgjidhje", sido që të quhen ato.

Konferencë për Kosovën në njëzetvjetorin e çlirimit

Shqipëria dhe liria e Kosovës

Bujar M. HOXHA

Vuajtjet e kosovarëve do të shpërbleheshin njëzet vjet më parë me lirinë e fituar. Hyrja e trupave të NATO-s më 12 qershor të 1999-s në Kosovë ishte çlirimi i tyre. Kosova këtej e tutje do të ishte e tyre: aty do të jetonin pa frikën se makineria policore dhe ushtarake serbe mund të bënte ç'të donte me ta, t'i dëbonte apo t'i vriste. Lufta e mbaruar nuk nënkuptonte fundin e përpjekjeve; sfida të reja ishin përpara. Për të folur për epopenë e para njëzet vjetëve, për ndërtimin e një Kosove të re si një shtet i pavarur, por dhe për rolin e Shqipërisë në të gjithë këtë, Fondacioni "ALSAR" organizoi të hënën një konferencë, mbajtur në Hotel "Tirana International".

Organizatorëve u duhet njohur merita e marrjes së iniciativës për mbajtjen e kësaj konference, për më tepër kur mungesa e aktiviteteve kremtuese në kryeqytetin e Shqipërisë për këtë datë jubilarë ishte e dukshme. Përzgjedhja me kujdes prej tyre e kumtuesve meriton, po ashtu, përgëzimin. Fjala e hapjes në konferencën me temë "Shtetformimi i Kosovës dhe Shqipëria: sfidat dhe perspektivat", i takoi sigurisht kryetarit të Fondacionit "ALSAR". Me fjalë të përzgjedhura e të mirëmbledhura, z. Mehdi Gurra iu drejtua kështu të pranishmëve: "Vetëm pak ditë pas krenimit madhështor në Kosovë të 20-vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s, të ditëlindjes së lirisë së Kosovës, siç do të shprehej presidenti Thaçi, mblidhemi këtu në Tiranë për ta analizuar rrugëtimin dydekadësh të shtetit më të ri të Evropës, shoqëruar dhe në kontekstin e marrëdhënieve me shtetin amë".

"Shtetformimi i Kosovës dhe Shqipëria: sfidat dhe perspektivat" është tema mbi të cilën do të ligjërojnë një sërë figurash të mirënjohura. Nëpërmjet kësaj konference kërkohet të hidhet akoma më tej dritë mbi arritjet kryesore të Kosovës si shtet demokratik e, krahas kësaj, mbi kontributin e Shqipërisë për gjatë procesit të gjatë e të vështirë të ndërtimit të këtij shteti.

Kosova ka ndryshuar në njëzet vjet, sfidat po ashtu. Beteja e çlirimit është fituar; kërkon ende përpjekje të mëdha sfida e ndërtimit të një shteti të drejtë e të mirë për të gjithë qytetarët kosovarë. Këtu është me vend të përmendet në mënyrë të përmblendhur thënia e ish-presidentit amerikan Bill Clinton, e ripërsëritur në krenimet e javës së shkuar: "78 ditët e sulmeve ajrore të NATO-s mund ta kenë fituar këtë luftë, por vetëm qytetarët e Kosovës mund ta fitojnë paqen!"

Kalvari i mundimeve që solli liria e munguar mori fund për popullin kosovar njëzet vjet të shkuara; ato mundime ua lanë vendin dhimbjeve të lindjes së shtetit të pavarur. Fati i qytetarëve kosovarë ishte tanimë në duart e tyre. U takonte atyre të vendosnin për të!

Kosova nuk është më krahina autonome e ish-Jugosllavisë, nuk përballet më me represionin policor dhe ushtarak serb. Ndërtimi i një

rendi demokratik është tani sfida e kosovarëve në vendin e tyre të lirë. Historia e këtyre dy dhjetëvjeçarëve ka treguar se ka pasur dhe keqpërdorim të lirisë, mbase dhe të menduar, mbase dhe të nxitur. Në emër të kësaj lirie është goditur me fjalë apo në mënyrë tjetër mbartësi i vlerave tradicionale. Dëmi i bërë ka ndodhur t'ia ketë kaluar dhe atij të para luftës!

Në mënyrë të natyrshme, Shqipëria i është gjendur pranë Kosovës në ecjen e saj drejt lirisë dhe shtetndërtimit. Vëmendja nuk ka munguar asnjëherë; ndihma ka qenë e çmuar. Përkujdesi i treguar është parë ndonjëherë dhe si një paternalizëm i panevojshëm, prej nga buron dhe një fërkim sporadik në marrëdhëniet reciproke.

Kosovarët vërshuan njëzet vite më parë në Shqipëri si të dëbuar prej dhunës ushtarake serbe; ardhja e tyre më pas u përshkrua dhe si turizëm patriotik. Kufiri midis dy shteteve është bërë gjithnjë e më simbolik në shkëmbimet njerëzore, veç nuk është aq simbolik në aspekte të tjera.

Si pjesë e një kombi, shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës nuk mund të bëjnë pa njëri-tjetrin, me të mirat dhe të këqijat e tyre. Të mirat duhet t'i vënë në shërbim të marrëdhënieve vëllazërore, të këqijat t'i mbajnë për vete. Gjendur në Ballkan, në një rajon ku lufta është gjithnjë pas dere, dy vendet janë të destinuara të bashkëjetojnë. Shqipëria dhe Kosova gjithashtu gjenden në një rrugë të përbashkët, me synim të përbashkët: të bëhen pjesë e Bashkimit Europian. Shumë prej sfidave të tyre janë të ngjashme kësaj. Në këtë pikëpamje, si dy pika uji është dendur dhe ligjërimi i klasave politike si këtej dhe andej kufirit.

Përvoja e rrugëtimit drejt BE-së ka sjellë dhe zhgënjime. Qytetarëve të Kosovës ende nuk u jepet e drejta për të udhëtuar pa viza në hapësirën Shengen, megjithëse janë përmblendur të gjitha kushtet e kërkuara. Instancat përgjegjëse në BE nuk e kanë mbajtur premtimin. Shqipërisë, në të njëjtën kohë, i shtyhet në mënyrë të vazhdueshme hapja e negociatave. A ka lidhje e tëra kjo me praktikën burokratike të zyrtarëve të Bashkimit Evropian? Është rezultat i keqsjelljes së klasës politike dhe administratës shtetërore në Kosovë dhe Shqipëri? Është pasojë e përpjekjeve të qarqeve antishqiptare? Apo ka të bëjë - mos qoftë kështu! - me përbërjen mbizotërueshmërisht myslimane të popullsisë së dy vendeve, në pritje për të parë ndryshime dramatike të imponuara në strukturën shoqërore?

Në të gjitha sfidat me të cilat ndeshen sot shqiptarët, uroj që këtë herë të mos i humbasin gjërat në tavolinë, siç ka ndodhur jo rrallë në të kaluarën tonë historike!

Dua ta shfrytëzoj këtë fjalë për të përmendur kontributin e paçmueshëm të Turqisë për shtetin e Kosovës, të anashkaluar me pa të



drejtë nganjëherë.

Turqia mori pjesë aktive në ndërhyrjen e NATO-s dhe në çlirimin e Kosovës, u angazhua fuqimisht në rindërtimin e vendit pas luftës, dhe ishte ndër vendet e para që ia njohu pavarësinë. Ndihma e Turqisë mike nuk ka munguar as në fushatën për të siguruar njohjen e shtetit të ri të Kosovës.

Fondacioni "ALSAR" e ndërmori iniciativën për organizimin e kësaj konference, siç kuptohet, në kuadër të krenimit të 20-vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë. Çështja kombëtare qëndron gjithmonë në themel të punës së fondacionit tonë. Kështu, ndonjë keqkuptim i krijuar gjatë përpjekjeve për ta organizuar këtë konferencë nuk ka patur asnjë arsye për ta penguar mbarëvajtjen e saj. Me gjithë keqardhjen për një keqkuptim të tillë, si fondacion kemi parë përpara, duke punuar dhe shpresuar që konferenca të jetë e suksesshme. Pesha e kësaj konference vihet në pah dhe nga fakti se në Tiranë kanë munguar aktivitetet e tilla kremtuese gjatë këtyre ditëve. Thuajse asnjë organizëm shtetëror apo joqeveritar nuk ka përgatitur një veprimtari të këtij niveli me këtë rast.

Prandaj, në emër të "ALSAR"-it, ju shpreh falënderimin të gjithë të pranishmëve për ardhjen në konferencë, e njëkohësisht i uroj punë të mbarë asaj!"

Krahas tij, fjalë përshëndetëse do të mbante z. Besnik Hoti, ish-zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Kosovës. Ligjëruesi mandej iu përmbajtën temës së konferencës duke e parë atë në kënde të ndryshme. Disa duke kujtuar ngjarje të asaj kohe, të para njëzet viteve, disa duke analizuar sfidat e së tashmes dhe së ardhmes. Rrëfime ngjarjesh, vuajtjesh, përvoja personale, përvoja në detyra shtetërore, kontribute të dhëna, shpërfaqje vizionesh, shprehje mirënjohjesh; një mozaik mendimesh të vyera, paraqitur denjësisht nga personalitete të mirënjohura.

"Konteksti ndërkombëtar i çlirimit të Kosovës: intervenimi i NATO-s si pararendës i së drejtës ndërkombëtare me fytyrë njerëzore", ishte kumtesa e parë e mbajtur në konferencën e së hënës.

Ligjëruesi, prof. dr. Blerim Reka, do të theksonte në fjalën e tij se, "Para dy dekadash, Kosova ndodhej midis pushtimit kolonial serb dhe përkrahjes ndërkombëtare. Dhjetë vite të aparteidit të Millosheviqit s'ka se si të mos e kthenin tërë opinionin botëror në favor të të vetmit popull në Evropë ndaj të cilit praktikohesh sistemi jugo-afrikan i Jan Smitit. Historia e Kosovës nën Serbi, pra, mund të përmbledhet shkurt: një shekull kolonializëm dhe një

dekadë aparteid. Bashkësisë ndërkombëtare iu deshën gati një shekull për të pranuar gabimin e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, kur kishte ndarë vëllëzërit dhe bashkuar armiqtë, kur ndau Shqipërinë kontinentale nga Shqipëria detare, dhe viktimizoi Kosovën për mosdaljen e Rusisë në Adriatik. Kjo më nuk mund të funksiononte në kontekstin e ndryshuar. Gjeopolitika e Uashingtonit zëvendësoi gjeopolitikën e Londrës. Nga pesë fuqitë e vitit 1913 mbeti vetëm një (Rusia) që në vitin 1999 ende mbronte ndarjen kombëtare të Londrës; ndërkaq që doli një e re (SHBA), që shpërfilli vendimet e ambasadorëve të atëhershëm evropianë. Gjenocidi në Ruandë dhe ai në Srebrenicë nuk do lejoheshin të përsëriteshin edhe në Kosovë. Intervenimi i NATO-s parandaloi një gjenocid të ri, duke intervenuar ushtarakisht kundër regjimit që e kishte bërë atë në Bosnje e Hercegovinë dhe e filloi edhe në Kosovë... Peshoi arsyetimi legjitim për të shpëtuar një popull të tërë nga shfarosja para argumentit legal për respektimin e normës. Deri në intervenimin e NATO-s ishin vlarë 13 mijë civilë shqiptarë dhe rreth një milionë e kishin braktisur Kosovën. Në vitin 1999, prandaj, fitoi sovraniteti njerëzor para sovranitetit shtetëror, ekzistenca e një populli para ekzistencës së një shteti, integriteti human para atij territorial... Prandaj intervenimi i NATO-s në vitin 1999, që solli çlirimin e Kosovës, ishte edhe paraardhës i një koncepti të ri të së drejtës ndërkombëtare: atij me fytyrë njerëzore, dhe jo i së drejtës ndërkombëtare që deri atëherë mbronte vetëm shtetet, duke flijuar njeriun. Çlirimi i Kosovës, pra, në vitin 1999 hapi një faqe të re në të drejtën ndërkombëtare: atë të sovranizimit postkolonial, mbështetur edhe me intervenim ndërkombëtar humanitar".

Analizues i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Shqipërisë, prof. dr. Ibrahim Gashi bëri një përmbledhje të tillë të perspektivës së tyre: "Konteksti historik, siç rezultoi nga një vështrim i vëmendshëm, ka luajtur dhe luan edhe më tej një rol crucial në zhvillimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës, si dy tersi të mëdha të një areali kombëtar gjeografik dhe etnik të përbashkët. Rrjedhimisht, ky kontekst ka ndikuar në krijimin e një vetëdije politike brendashqiptare për bashkim dhe krijimin e një shteti të përbashkët. Në anën tjetër, konteksti politik, në rrethana specifike të krijuara në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, ka nxitur prirjen për krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Perspektiva e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë determinohet nga këto dy kontekste".

Për kontributin e Shqipërisë në prirjen e kosovarëve të dëbuar prej represionit serb asokohe foli dr. Sadik Mehmeti, një tjetër i ftuar. "Shpërnguljet masive me dhunë të shqiptarëve nga trojet e tyre stërgjyshore, që filluan në vitin 1877/1878, e për të vazhduar edhe më vonë, pas largimit të Perandorisë Osmane nga këto troje, gjatë

luftërave ballkanike, pikërisht në vitet 1912-1915, pastaj midis dy luftërave botërore (1919-1941) dhe pas Luftës së Dytë Botërore (periudha midis viteve 1950-1960), e deri në vitin 1998-1999, kur afërsisht mbi 800 mijë persona lanë vendin e tyre dhe u drejtuan për në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi etj., si dhe në vendet e tjera të Evropës dhe më gjerë, paraqet një nga tragjeditë më të mëdha që i ka ndodhur këtij populli.

Shpërngulja masive me dhunë e shqiptarëve nga Kosova gjatë këtyre periudhave, dihet mirëfilli se lidhet me procesin e politikës shkombëtarizuese që ndiqnin qarqet drejtuese serbe të Beogradit ndaj popullatës autoktone në këto vise dhe me pretendimet territoriale të serbëve në dem të tokave shqiptare dhe popullatës së saj.

Periudha e fundit e shpërnguljes, pra ajo midis viteve 1998-1999, ndonëse e shkurtër, ajo, si asnjëherë më parë, ishte shumë masive, ku afërsisht mbi 800 mijë persona lanë vendin e tyre dhe u drejtuan kush si mundi dhe kah mundi.

Në gjithë këto periudha të sipërpërmendura, të parit që do t'i ketë renë hise dhe barra kryesore për të strehuar dhe mirëpritur shumë nga vëllëzërit e tyre të shpërngulur me dhunë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, ka qenë pa dyshim shteti shqiptar dhe popullata mikpritëse e tij.

Kështu, vetëm në luftën e fundit në Kosovë (1998-1999), Shqipëria ishte, pa dyshim, jo vetëm pritëse e parë e të dëbuarve me dhunë nga vatrata e tyre, por ajo akomodoi dhe u përkujdes për rreth 65-70 % të numrit të përgjithshëm të rreth 800 mijë shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova.

Pikërisht këtë kontribut të shtetit dhe popullit shqiptarë, të mbështetur mbi të dhëna dhe statistika të ndryshme, synon ta vërë në dukje kumtesa ime", tha ai.

Dr. Halil Hyseni foli për pranverë kosovare: "Pranvera e vitit 1999 erdhi në Prishtinë. Pranvera lulëzoi jo vetëm pse u vadit me gjakun e heronjve kosovarë, erdhi jo vetëm për shkak të potencës ushtarake të NATO-s. Ato nuk do të mjaftonin. Kolicioni fitimtar do të ishte i paplotë. Liria lulëzoi në Prishtinë sepse në shërbim të saj, në mbrojtje të vlerave, mblodhi edhe shërbëtorët më të spikatur të paqes".

Ligjëruan gjithashtu në konferencë dhe Memli Krasniqi, Skënder Luftiu, Shaban Murati dhe Ksenofon Krisafi. Çdonjëri me kumtesë mjaft interesante. Tema e zgjedhur nga dr. Memli Krasniqi ishte, "Shtypi amerikan mbi luftën e Kosovës (1998-1999)", Skënder Luftiu u përqendrua te çlirimi i Kosovës dhe vendosja e protektoratit ndërkombëtar. Diplomati dhe publicisti Shaban Murati analizoi "Komplikimet e brendshme dhe ndërkombëtare të procesit të njohjes së Kosovës". Prof. dr. Ksenofon Krisafi rikujtoi kontributin personal dhe të shtetit shqiptar në ato kohë të vështira për Kosovën. "Në forumet ndërkombëtare për mbrojtjen e Kosovës", titullohej kumtesa e mbajtur prej tij.

E jashtëzakonshme

Shitet arma që i mori jetën Van Goghut

Revolveri, i cili mund të jetë përdorur nga piktori Vincent van Gogh për t'u vetëvrasur, u shit në një ankand për 162 500 euro, rreth tri herë më shumë sesa pritej. Arma e ndryshkur u ble përmes telefonit nga një koleksionist privat. Ajo u gjet nga një fermer në vitin 1965 pranë fshatit kur artisti kaloi ditët e fundit të jetës. Ishte afërsisht e njëjta



periudhë kohore dhe me të njëjtin kalibër plumbi që i mori jetën Van Goghut.

FOTO E DITES



Një vajzë shkon drejt biçikletës së vet në një plazh në Guaruja, shteti i Sao Paulos në Brazil. Fotografia është publikuar te "Zëri i Amerikës".

E rrallë

Ariu i uritur polar udhëton 1 500 kilometra dhe zbret në qytet



Një ari i uritur polar është vërejtur këtë javë në një qytet industrial rus në Siberinë veriore. Ariu është parë në Norilsk dhe raportohet se udhëtoi 1

500 kilometra larg vendbanimit të vet natyror Arktik. Siç vërehet në pamjet e publikuara nga mediet e huaja, ariu duket i raskapitur.

BARSOLETA E DITËS



Dy shoferë po udhëtonin me kamion në një rrugë të dendur nga mjegulla. Për një çast ai që drejtonte timonin zgjoi tjetrin që po flinte dhe e pyeti:
- Mos ka këtupari pinguinë?
- Jo, - ia pritë dhe i bëri me dije, - s'ka mundësi të ketë këtu pinguinë.
- Ta hajë dreqi, ta hajë, shtypëm një murgeshë pra!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min



Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg

Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,
Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00
"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown



Regjia: Tate Taylor


Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Gjithçka që po ju ndodh sot nuk është ajo që kishit parashikuar. Nëse tentoni të reagoni mund të keni pasoja në biznes ose në karrierë.



DEMI
Durimi është një nga cilësitë tuaja më të mira, por në disa raste persona të tjerë bëjnë mirë të mos jua sprovonjë atë.



BINJAKËT
Keni tendencën të bëni zgjedhje impulsive sot dhe ato mund të rezultojnë të gabuara në të ardhmen. Vendosni disa limite për punët që keni marrë përsipër.



GAFORRJA
Në fund do të triumfojë e vërteta dhe nëse tani ndiheni disi të turbulluar për çfarë po ndodh rreth jush, nuk duhet të shqetësoheni fare.



LUANI
Edhe pse keni shumë ide sot nuk doni të veproni sepse shikoni situata aspak të qarta përballë. Në çaste të caktuara bëni mirë t'i besoni instinktit.



IRGJËRESHA
Marrëdhëniet njerëzore sot për ju paraqiten pak kaotike. Nuk do të mbani të njëjtin qëndrim me persona të caktuar.



PESHORJA
Dita e sotme do të ketë mjaft lëvizshmëri dhe ngjarje për ju. Jo të gjitha do të jenë të mira, por në vende të ndryshme do të përjetoni ngjarje të ndryshme.



AKREPI
Edhe pse nuk kanë nisur ende pushimet për ju, jeni gjithmonë me mendjen për të ikur. Po ëndëroni vende plot diell dhe det.



SHIGJETARI
Sot do të merreni me shumë aktivitete sociale, por nuk do të lini pas dore as detyrimet tuaja në karrierë që do të pësojnë ndryshime pas pak ditësh.



BRICJAPI
Çdo gjë që po bëni për momentin ka marrë gjithë vëmendjen tuaj sepse doni ta zgjidhni sa më mirë dhe brenda kohës së duhur.



UJORI
Do ta kënaqni kurozitetin tuaj sot lidhur me një çështje të caktuar sepse dikush do t'ju sqarojë në detaje gjithçka që do t'i kërkonte.



PESHQIT
Sot dita është e mbushur me aktivitete sportive pasi kjo ju bën të ndiheni plot energji dhe jetë. Keni vendosur një ekuilibër shumë të mirë me veten.

Shawn Mendes dhe Camila Cabello sërish bashkë për një këngë



Shawn Mendes dhe Camila Cabello po sjellin një bashkëpunim. Lajmi u konfirmuar përmes një videoje të shkurtër të postuar në rrjetin social "Instagram". Thashethemet

për një këngë bashkë nisën në Grammy, pasi Shawn dhe Camila kishin lëvdatat për njëri-tjetrin. Kjo këngë është dueti i dytë i artistëve, pasi i pari u lëshua në vitin 2015.

Drake publikon klipin e ri



Së fundmi Drake ka publikuar dy këngë të reja. Pas fitimit të kampionatit të NBA-s nga Toronto Raptors, reperi kanadez ka premtuar se do të publikojë dy këngë të reja për të festuar. Derisa njëra është bashkëpunim me Rick

Ross, "Money in the grave", është kënga tjetër, ajo me titullin "Omerta", që ka marrë vëmendjen e fansave. Në "Omerta" Drake ka sjellë një tekst me të vërtetë të menduar mirë dhe me rreshta që dëgjuesve i mbeten në kokë shumë shpejt.



Sëmuret Rita, detyrohet t'i anulojë koncertet

Rita Ora nuk do të jetë e pranishme në koncertin veror në Islandë "Secret Solstice". Këngëtarja pati një lajm të keq për të gjithë fansat e saj që po prisnin për ta parë e dëgjuar. Ajo ka njoftuar se shkak është gjendja e saj shëndetësore dhe se mjekët i kanë

këshilluar t'i anulojë koncertet derisa gjendja e saj të stabilizohet. "Kam probleme me një infeksion në gjoks që po vazhdon të kthehet kohë pas kohe. Jam këshilluar që të marr pak kohë pushim që të rikuperohem", ka shkruar Rita Ora në rrjetin social "Instagram".

Bebe Rexha tregon se Katy Perry e ndihmoi ta largojë stresin e rrjeteve sociale

Këngëtarja e njohur Bebe Rexha ka thënë se këngëtarja Katy Perry e ka ndihmuar atë të kalojë disa komente negative që i mori në rrjetet sociale. Këtë e tha Rexha në një intervistë për "The Sun". Rexha tha se ishte në një tur në Brazil bashkë me Perryn, ndërkohë ajo e këshilloi atë në këtë aspekt. "Ato ditë isha në depresion, ndërkohë lexova një 'Tweet' ku më qeshën, nga kjo u nervozova dhe u stresova shumë. Kështu Katy ishte pranë dhe më tha që nuk duhet të merrem me këso komente", ka treguar Bebe Rexha.





QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Sportistët, të zhgënjyer me politikën

Mosmiratimi i Ligjit për Sponsorizim nga deputetët e Kuvendit të Kosovës ka shkaktuar shumë pakënaqësi në komunitetin e sportit. Komiteti Olimpik, shumica e federatave sportive si dhe sportistë e ish-sportistë kanë reaguar duke kërkuar që sa më shpejt të korrigojohet ky veprim dhe të miratohet ligji në fjalë pasi, sipas tyre, është jetik për sportin e Kosovës

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Institucionet sportive dhe sportistë të shumë në Kosovë kanë shprehur haptas zhgënjimin me politikën, përkatësisht veprimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për mosmiratimin e Ligjit për Sponsorizim. Sportistët assesi nuk po arrijnë të kuptojnë se si deputetët nuk e miratuan ligjin që është jetik për sportin e Kosovës.

Komiteti Olimpik i Kosovës ka reaguar pas mosmiratimit të këtij ligji që, sipas tij, do të krijoheshin edhe qindra vende pune dhe do të ndalej vala e largimit të rinisë nga Kosova. "KOK-u ka mbetur tej mase i habitur se si një amendament që e dërgon përpara zhvillimin e sportit në Kosovë, i cili do të krijonte qindra dhe mijëra vende të reja të punës, do ta ulte shkallën e informalitetit, do ta ndalte valën e largimit të rinisë nga Kosova, nuk gjeti përkrahjen edhe nga deputetët, të cilët, jo rrallëherë, dinë të krenohen me arritjet e sportistëve", thuhet në reagimin e KOK-ut.

Ndërsa Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës kërkon nga Kuvendi i Kosovës që në seancën e radhës ta votojë amendamentimin e Ligjit për Tatimin e të Ardhurave në Korporata, i cili e mundëson harmonizimin me Ligjin për Sponsorizim, i cili është jetik për zhvillimin e sportit, në veçanti për futbollin. "Ne si KE i FFK-së u bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që në seancën e radhës të jenë në numër të mjaftueshëm dhe ta kalojnë amendamentimin e këtij ligji, ngaqë kjo do të ishte përkrahja e tyre më e madhe për sportin në këtë periudhë. Në kohën kur sporti ynë po i radhit sukseset e njëpasnjëshme e kur futbollit është bërë ambasadori më i mirë i vendit në botë dhe sukseset e djemve tanë të Përfaqësues po na bëjnë krenarë të gjithëve, është obligim i secilit prej nesh që të jemi të përgjegjshëm dhe të punojmë për ta përkrahur sa më shumë sportin. Sportistët tanë po e bëjnë punën e tyre me krenari e përgjegjësi në çdo arenë. Tani mbetet radha e deputetëve që të dëshmojnë se janë përkrahës të njëmendtë të zhvillimit të sportit, duke e votuar Ligjin në fjalë", thuhet në reagimin e Federatës së Futbollit.

Një tjetër federatë sportive, Federata e Basketbollit, ka shprehur habinë se si deputetët nuk e miratuan Ligjin për sponsorizim. FBK-ja mbetet e befusuar me reagimin e deputetëve, pasi të njëjtit krenohen me sukseset e sportistëve. "Federata e Basketbollit nuk e ka të qartë se si mundet që një amendament i cili e dërgon përpara zhvillimin e sportit kosovar në përgjithësi, nuk e gjeti përkrahjen edhe nga deputetët, të cilët



vazhdimisht krenohen me të arriturat e sportit dhe të sportistëve, pasi që tashmë dihet botërisht se sporti është ambasadori më i mirë i Kosovës në botë dhe janë sportistët ata që po ia përmirësojnë imazhin në vazhdimësi vendit tonë. Me këtë veprim të deputetëve, sporti, përkatësisht basketbolli kosovar, vetëm se e ka bërë një hap prapa, duke marrë parasysh gjendjen financiare në klubet kosovare, ku mungesa e sponsorëve në vitet e fundit është kryekëput e lidhur me mosmiratimin e këtij ligji dhe amendamenti", thuhet në reagimin e FBK-së.

Një tjetër federatë sportive që po arrin suksese në arenën ndërkombëtare, Federata e Hendbollit, është e indinjuar me sjelljen e deputetëve në prag të Kampionatit Botëror për Juniorë që mbahet në Spanjë. FHK-ja kërkon që urgjentisht të votohet ky ligj që është i domosdoshëm për hendbollin dhe sportin në përgjithësi. "Në kohën kur djemtë tanë janë në vllugun e përgatitjeve për pjesëmarrje historike në Kampionatin Botëror të Juniorëve, sporti në vend mori një goditje të papritur. Në Kuvendin e Kosovës nuk kaloi Ligji për Tatimin e të Ardhurave në Korporata, saktësisht amendamenti që do t'i hapte rrugë aplikimit të Ligjit të Sponsorizimit në Sport, Kulturë e Rini. Aplikimi i Ligjit për Sponsorizim është jetik për hendbollin dhe sportin kosovar në përgjithësi. Në kohën kur po kalojmë barriera të mëdha dhe po shkelim terriore të reja falë angazhimit të jashtëzakonshëm, përkrahja nga shteti, por edhe nga sektori privat është me shumë rëndësi për komunitetin tonë. Ndaj kërkojmë nga kuvendarët e nderuar që të shqyrtojnë edhe një herë vendimin që morën dhe kalimin e këtij amendamenti ta kenë prioritet të menjëhershëm", thuhet e Federatës së Hendbollit. Sipas këtij reagimi, përmes sportit Kosova po arrin suksese të jashtëzakonshme edhe në rrafshin diplomatik, politik dhe të njohjes së shtetit.

Një reagim të ashpër e bëri edhe përzg-

jdhësi i Kosovës në xhudo, Driton Kuka. Ky i fundit pret suksese të reja nga Lojërat Evropiane, kurse deputetët i porosit t'i lënë anash kauzat politike kur është në pyetje sporti. "Besoj se edhe kësaj radhe do të na gëzojë me medalje nga Lojërat Evropiane në 'Minsk 2019'. Sporti, përkundër sukseseve në Kuvend, nuk mori përkrahjen e duhur për t'u finalizuar Ligji për Sponsorizim. S'e kemi merituar kështu aspak. Ju që s'e votuat duhet të flisni publikisht për arsyet e juaja, nëse keni arsye të qëndrueshme, ne jemi gati të ulemi e ta diskutojmë, por lërimi kauzat politike kur është në pyetje sporti. Kryefjala e shtetësisë së Kosovës është sporti. E dini ju të gjithë kur takoheni me politikanë të huaj me çka lavdëroheni më së shumti", ka shtuar Kuka.

Në lidhje me këtë veprim të deputetëve kanë reaguar edhe federatat e tjera sportive, trajnerë, sportistë dhe ish-sportistë.

Gashi bën thirrje për amendamentimin dhe zbatimin e Ligjit për sponsorizime

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që ta votojnë amendamentin i cili avancohet fushën e kulturës, të rinisë dhe të sportit, duke rritur krijimtarinë dhe cilësinë. "Ministria jonë, përpos që ka themeluar komisionin për vlerësimin e vërtetimeve për sponsorim, tashmë ka përfunduar të gjitha procedurat dhe ka vërtetuar disa sponsorime të cilat deri më tani nuk po arrijmë t'i zbatojmë për shkak të zhargitjes së institucioneve financiare, në këtë rast Administratës Tatimore të Kosovës", ka thënë ministri Gashi. "Është e pakuptueshme përse po ndodh kjo bllokadë. Mbështetja e sportistëve dhe artistëve nuk bëhet vetëm duke qëndruar në tribuna, salla sportive e të kulturës si spektatorë, por duke krijuar mundësi ligjore dhe financiare për avancimin e tyre", është shprehur Gashi.

SHKURT

Short i mirë për boksierët e Kosovës

Katër boksierët e Kosovës, Donjeta Sadiku, Patriot Behrami, Ardit Delijaj dhe Shpëtim Bajoku, kanë mësuar kundërshtarët në Lojërat Evropiane "Minsk 2019". Donjeta Sadiku në 1/8 e finales në kategorinë 60 kg do të përballet më 23 qershor me boksieren daneze Ditte Frostholm. Ardit Delijaj më 22 qershor në kategorinë deri në 81 kg përballet me Gor Nersesyan të Armenisë, në 1/16 e finales. Ndërsa Patriot Behrami kaloi rrethin e parë pa luftë, ndërsa në 1/8 e finales kryqëzon dorëzat me boksierin nga Kroacia, Marko Zeljko (69 kg). Shpëtim Bajoku në kategorinë 64 kg do të boksojë më 23 qershor ndaj boksierit nga Izraeli, Ahmad Shtiw. Trajnerët e boksit, Shefki Bogujevci dhe Besim Brahimi, janë shfaqur të kënaqur me shortin dhe presin që xhiron e parë ta kalojnë pa problem dhe t'i vazhdojnë garat për medalje.

Drita prezanton Blakçorin

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita, ka arritur ta transferojë ish-futbollin e Llapit, Ilir Blakçorin. Ky transferim llogaritet shumë i madh nga skuadra gjilanasë për faktin se Blakçori është ndër më të mirët në pozicionin e tij në futbollin e Kosovës.

Rapa lë Luftëtarin për Gjilanin

Mbrojtësi shqiptar Oltion Rapa i është bashkuar Gjilanit në Superligën e Kosovës duke kaluar nga Luftëtarin në Shqipëri. Në njoftimin e Gjilanit bëhet me dije se lojtari ka nënshkruar kontratë dyvjeçare.

Rahoveci zëvendëson Locin me Plantakin

KB Rahoveci e zyrtarizoi Neven Plantak trajner të ri vetëm një ditë pas njoftoi ndarjen me trajnerin Buar Loci. Trajneri kroat do t'i drejtojë nënkampionët e Kosovës në editonin e ri basketbollistik 2019/2020. "Plantak ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me Rahovecin dhe gjatë muajit gusht pritet të arrijë në vendin tonë, kohë kur edhe fillojnë përgatitjet për një vit intensiv që na pret përpara si në Superligë, por edhe në gara ndërkombëtare. Plantak vjen në një moment kyç dhe historik për Rahovecin, derisa përvoja e tij do të shërbejë shumë në rezultatet e skuadrës sonë", thuhet në njoftimin e Rahovecit. Trajneri kroat ka qenë edhe trajneri i Trepçës nga Mitrovica dhe Vllaznisë së Shkodrës.

Më 10 gusht zhvillohet miqësorja Feronikeli - Milani

DRENAS, 20 MARS - Skuadra e Feronikelit e ka zyrtarizuar ndeshjen miqësore ndaj gjigantit evropian, AC Milan. Skuadra kampione e Kosovës ka njoftuar se ndeshja do të zhvillohet më 10 gusht. "Është arritur marrëveshja për supersfidën që do të zhvillohet në mes të Feronikelit dhe skuadrës legjendare të Serisë A, AC Milan. Pas

negociatave që kanë filluar që një kohë, është finalizuar marrëveshja për këtë miqësore të madhe. Skuadra e AC Milan do të vijë për herë të parë në Kosovë, për ta zhvilluar miqësoren me kampionët e Kosovës, Feronikelin. Një ndeshje si kjo konfirmon edhe një herë seriozitetin që ofron klubi kampion i Kosovës", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

Presidenti i Feronikelit, Naser Ramaj, nënshkroi të enjten marrëveshjen me menaxherin Agron Selimi, i cili ishte ndërmjetësuesi i marrëveshjes në këtë rast. Detaje për fillimin e lojës nuk janë caktuar ende, por që do të komunikohen për opinionin me kohë. Kjo pa dyshim se është ngjarja më e madhe në futbollin e pasluftës.



'Tronditet' Vushtrria, kryetari jep dorëheqje

VUSHTRRI, 20 QERSHOR (ER) - Skuadra e Vushtrrisë u rikthye në elitën e futbollit të Kosovës, por ky klub sot (e enjte) mori një lajm aspak të mirë. Një nga më meritoret për suksesin në Ligën e Parë, Naser Imeri, ka dhënë dorëheqje nga detyra e kryetarit të klubit. Imeri ka bërë me dije se një nga arsytet e këtij largimi është financat, pasi në tre vjet është investuar shumë dhe se kompania 'Ariani Company' e ka të pamundur t'i mbulojë shpenzimet për Superligë. "Arsyeja tjetër ka të bëjë me aspektin financiar ku ne si kompani konsiderojmë se kemi investuar shumë këto vite të udhëheqjes sa kemi qëndruar në ligën e parë. Dhe fakti që tashmë jemi pjesë e



Superligës gjatë analizave të shumta kemi ardhur në përfundim se ne si kryesi aktuale dhe kompania jonë të vetëm, e kemi të pamundur t'i mbulojmë shpenzimet minimale për të krijuar një ekip konkurrues që të mbijetojë në Superligë", ka thënë Imeri, i cili ka premtuar se kompania "Ariani Company" do të vazhdojë ta përkrahë financiarisht skuadrën e Vushtrrisë. "Përkundër lajmit të keq për mosvotimin e Ligjit për sponzorim nga Kuvendi i Kosovës, ne si 'Ariani Company' zotohemi se kushdo që të vijë në udhëheqje të klubit do të vazhdojmë të përkrahim financiarisht së bashku me kompanitë e tjera", ka deklaruar Imeri.

Sarri: Fitoret janë detyrim i Juves

TORINO, 20 QERSHOR - Pas aventurës njëvjeçare në Londër, ku drejtoi Chelsea dhe arriti ta fitojë Ligën e Evropës, Maurizio Sarri, rikthehet në Itali këtë herë për t'u ulur në stolin e kampionëve të Juventusit.

Zyrtarizimi i Sarrit në stolin bardhezi u bë pak ditë më parë, ndërsa të enjten tekniku doli para medieve, për ta dhënë intervistën e tij të parë si trajner i Juventusit, një skuadër me të cilën rivalizoi për tre sezone, kur drejtonte Napolin. "Ndjesia ishte e fortë dhe jo për kohën kur erdhi, por për mënyrën se si erdhi. Kam parë një shoqëri të vendosur dhe kompakte në vendimin për të afruar një trajner, gjë që e has për herë të parë në 30 vjet. Emocioni është i fortë, por nuk është se vij nga klube amatore. Kam një karrierë që ka ardhur hap pas hapi dhe kam provuar klube të ndryshme. Mos harroni që vij nga Chelsea, një skuadër e madhe evropiane, ndonëse me më pak histori se Juventus. Mund ta quaj një hap të madh përpara emërimit tim këtu", ka thënë Sarri.

I pyetur se cilat janë objektivat e tij me Juventusin, Sarri është përgjigjur: "Pres që të zgjohem në mëngjes dhe të studioj se si t'i fitojmë ndeshjet. Juventus ka detyrimin të futet në Ligën e Kampionëve me objektivin për të triumfuar në fund, por të njëjtat synime kanë edhe 8-9 klube të tjera të mëdha në Evropë, ndaj kjo gjë bëhet e vështirë. Sa i përket kampi-



onatit, përgjegjësia është më e madhe, pasi kjo skuadër fiton prej tetë sezonesh radhazi dhe duhet ta mbrojë titullin". Trajneri Sarri ka folur edhe për mundësinë që Cristiano Ronaldo dhe Paulo Dybala të luajnë bashkë. "Futbollistë me cilësitë e tyre mund të luajnë kudo dhe ta ndryshojnë

interpretimin e ndeshjes, ndaj nuk është një problem", ka shtuar ai. Sarri është pyetur edhe për përballjen në mes të Napolit dhe Juventusit. "Nëse më duartrokasim është një histori dashurie. Edhe nëse më vërshëllojnë, është një histori dashurie dhe unë dua të mirën gjithmonë", ka deklaruar Sarri.

SHKURT

Ajaxi shpërblen Ten Hagin

Trajneri i Ajaxit, Erik Ten Hag, ka rinovuar deri në vitin 2022, me skuadrën e Amsterdamt dhe kështu është shpërblyer për sezonin e shkëlqyer që bëri. Kontrata e tij skadonte më 2020, por klubi holandez vendosi që t'ia rinovojë për dy vjet të tjera, për të treguar se projekti i Ajaxit do të bazohet mbi të. Sezoni që lamë pas ishte një sezon ëndërrash për të dhe Ajaxin, pasi fitoi Kupën e Kampionatit dhe shkoi një frymë larg finales së Ligës së Kampionëve duke shkualifikuar Realin dhe Juventusin.

Real, 130 milionë euro dhe dy lojtarë për Neymarin

Real Madridi synon të përforcojë edhe më shumë ekipin për sezonin e ardhshëm. Pesë transferime vetëm në muajin qershor, tregojnë se Real Madridi e ka nisur seriozisht punën për të krijuar një skuadër fituese dhe që mos të përsëriten zhgënjimet e një sezoni më parë. Presidenti Florentino Perez është një adhurues i madh i brazilianit Neymar dhe për ta transferuar në "Bernabeu" po bën të pamundurën. Sipas "Mundo Deportivo", Real është gati të paguajë 130 milionë euro në arkat e PSG-së dhe ofron njërin në mes Gareth Bale dhe James Rodriguez për ta transferuar Neymarin në Madrid.

Giampaolo, trajner i ri i Milanit

AC Milani e ka zyrtarizuar Marco Giampaolon si trajner të ri të skuadrës. Ai ka nënshkruar kontratë dyvjeçare, me opsion për një të tretë. Giampaolo i dha fund kontratës me Sampdoria pas tre sezonesh për ta nënshkruar me Milanin, kontratë që besohet se është dy milionë euro për sezon. Ai bëhet trajneri i 60 te Milani, apo i teti që kur Massimiliano Allegri u largua në janar të vitit 2014. 51-vjeçari zëvendëson Gennaro Gattuson që u largua pasi Milani nuk arriti të kualifikohet në Ligën e Kampionëve.

Aubameyangi, zëvendësuesi i Lukakut në United

Romelu Lukaku mund të transferohet në këtë afat kalimtar në skuadrën e Interit, kurse Manchester Unitedi ka filluar ta analizojë futbollistin që mund të jetë zëvendësues ideal për sulmuesin belg. "talkSPORT" raporton se sulmuesi që do të 'aterrojë' në "Old Trafford" është Pierre-Emerick Aubameyang i Arsenalit. 30-vjeçari ka zhvilluar 49 ndeshje dhe ka shënuar 32 gola për Arsenalin, kurse në të kaluarën ka luajtur edhe për Borussia Dortmundin.

Bayerni dhe City në garë për yllin e Atletico

Bayern Munchen dhe Manchester City janë dy skuadrat e interesuara për mesfushorin Rodri. Rodri erdhi këtë sezon tek Atletico Madridi nga Villareali dhe i ka mahnitur të gjithë me lojën e tij. Paraqitjet e mira bënë që ai të zinte rol kryesor edhe në kombëtare. Guardiola ka shprehur simpati për Rodrin si lojtar që para se të bashkohej me Atletico, ngaqë përshatet edhe ideologjia e lojës. Pritet që të dyja ekipet të futen në garë dhe t'i nisin ofertat zyrtare për shërbimet e tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnica i Klinicka Sluzba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Qendra e Shendetit Mendor me Shtëpi për Integrim në Bashkësi-Ferizaj

Nr.p 284/2019 data 20.06.2019

SHPSHIB në Ferizaj, në bazë të nenit 8 pika 1 dhe 2 e të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; Neni 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; neni 5, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003/2016; ne baze te Kerkese së aprovuar nga Drejtori i SHSKUK-së te dates 17.06.2019 publikon:

KONKURS PUBLIK

Titulli i vendit të punës	QSHMSHIB në Ferizaj	Nr. pozitav të lira pune
I.Mjke Specialist Psikiater		Një (1)

Institucioni: QSHMSHIB në Ferizaj
Norma e punës: Orari i plotë.
Kontrata: Sipas legjislacionit ne fuqi
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist Psikiater

I Raporton: Drejtorit QSHMSHIB në Ferizaj.
Kategoria funksionale/Grada: H-DOCTOR –SPECIALIST
Kocficienti 8.4 11-659/1

Titulli i punës: Mjke Specialist Psikiater

Qëllimi kryesor i vendit të punës

- Zbatimi dhe respektimi i ligjshmërisë

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Të vlerësoi, diagnostifikoi, trajtoj dhe përcjellë gjendjen e shëndetit mendor të klientëve në QSHM/SHIB, mjedisin ku ata jetojnë si dhe përcjellin gjendjen e përgjithshme shëndetësore të klientëve.
- Të organizoi dhe të marrë pjesë në preventiven primare, sekondare dhe terciare së bashku me ekipen e shëndetit mendor dhe agjensioneve/institucioneve të tjera.
- Të punoi në kordinim me profilet tjera profesionale (infermiere/ët, punëtorin social, këshilltarin psikosocial, psikologun dhe psikiatrin të tjerë) në QSHM/SHIB bazuar në principet e punës në ekip.
- Të kontriboi në kordinim me ekipin multidisiplinar që të i përgjigjet nevojave reale të përkujdesjës së Shëndetit mendor të klientëve dhe ofrimin e shërbimeve më të mira.
- Si pjesë e ekipit multidisiplinar të realizoj vizita klientëve ose personave tjerë relevant që kanë të bëjnë me klientin në shtëpi në tërë zonën përgjegjëse të shërbimit profesional të shëndetit mendor.
- Të punojnë me klientë duke ofruar spekter të gjërë intervenimesh apo aktivitete terapeutike (intrvenime individuale apo në grupe, psikoterapi, psikoedukim, terapi suportive apo familjare) dhe të vlerësojë gjendjen e klientëve në periudha të caktuara.
- Të garantoj vazhdueshmërin e përkrahjes së mardhënjes terapeutike në mes të shërbimeve të shëndetit mendor dhe shfrytëzuesve si dhe familjeve të tyre.
- Të identifikohen nevojat sociale të klientëve dhe të informon dhe bashkëpunon me punëtorin social për intervenimet e nevojshme.
- Të aktivizojnë dhe ofrojnë aktivitete grupore me klientin dhe familjar në lidhje me tema të caktuara në pajtim me anëtar e tjerë të ekipës.
- Të lehtësoi dhe përkrahë krijimin e grupeve – vetë – ndihmëse për klient dhe familjar.
- Të marrë pjesë në mënyrë aktive në gjitha mbledhjet e stafit (ditorë).
- Të bashkëpunoi me stafin në definimin dhe zbatimin e trajtimeve gjithëpërfshirëse individuale për çdo klient.
- Të ofroi përkrahje dhe të bashkëpunoi me departamentin psikiatrik në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm në lidhje me përcjelljen e klientëve në QSHM si dhe të jetë në gjendje gadishmërie gjatë ditës dhe kujdestarive të natës .
- Të aktivizoi përkrahje dhe ndëgjim psikoterapeutik dhe të mundësoi integrimin e klientëve në grupe terapeutike dhe në jetën e përditshme të shërbimeve.
- Të siguroi shfrytëzim racional (kujdeshëm dhe në mënyrë korrekte) përdorimin e medikamenteve psikotropike, të bëjë vlerësime periodike mbledhje të dhënave dhe të i kushtohet vëmendje e posaçme medikamenteve me ‘ efekt të gjatë ‘.
- Të rreptkoi kodet e caktuara të etikës dhe të konfidencialitetit gjatë praktikës.
- Të jetë përgjegjës për elaborimin e shënimeve personale dhe atyre klinike për të gjithë shfrytëzuesit.
- Të përkrah dhe rishikoj kuantitetin e punës së infermiere në bashkëpunim me kryeinfermierierët.

- Të siguroi dhe mundësoi trajnimin e stafit, posaçërisht në lidhje me praktiken e shëndetit mendor në bashkësi.
- Të përkushtohet vëmendje e posaçme rrezikut nga përdorimi ekskluziv të modelit radikal në trajtimin e rregullimeve mendore dhe të përdorimit të veprimeve institucionalizuese (hospitalizimin).
- Të marrë pjesë në pranimin dhe lëshimin e klientëve në përgjithësi.
- Të siguroi anamnezë komplete dhe të detalizuara të historisë klinike të klientëve dhe diskutimin e tyre me stafin relevant.
- Të promovoi programe rehabilituese, integruese që mundësoin punësimin e klientëve.
- Të përkrah procesin e deinstitutionalizimit në regjionin ku punon.
- Të bashkëpunoj me Mjekësinë familjare, shërbimeve sociale, OJQ – të në komunë dhe agjensioneve tjera relevante.
- Të marrë pjesë në trajnimet e organizuara për punëtor të Shëndetit mendor
- Përgjegjësit e tjera të përcaktuara nga Drejtori i Shërbimit Profesional të shëndetit mendor.

Kualifikimi (shkollimi) dhe përvoja e kërkuar:

- Fakulteti i Mjekësisë – (kopje diplomës e noterizuar)
- Licenca e specialistit të Psikiatrisë nga MSH apo OMK (kopje diplomës e noterizuar)
- Shkathtësi kompjuterike
- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze është e dëshirueshme
- Çertifikatë që nuk jeni i dënuar ose nën hetime lëshuar nga gjykata kompetente - (original)
- Letërnjoftim – (kopje)
- Çertifikatë të lindjes jo më e vjetër se 3 muaj (original)

Procedurat e konkurrimit :

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat të kërkuar me konkurs si dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarik nga data e publikimit (shpalljes).

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Administratës në QSHMSHIB në Ferizaj

Ferizaj Datë: 21.06.2019

U.D Drejtori i QSHMSHIB
Menduhije Mustafa



Republika e Kosovës- Republika Kosova- Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave duke u bazuar në Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 22 paragrafi 3, vazhdon afatin e konkursit të shpallur më datë **06.06.2019** edhe për shtatë (7) ditë tjera kalendarike, për shkak se nuk është arritur pranimiti i një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti ctnik dhe gjinor, për pozitën :

Zyrtar i Logjistikes (1 pozitë)

Kushtet e vendin e punës mbeten të njëjta si në konkursin e mëparshëm. Kandidatët që kanë aplikuar në afatin e parë të konkursit për pozitën e përmendur nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

Departamenti i Administratës / ARH

OBAVEŠTENJE ZA PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Regulativni Autoritet Železnica, na osnovu Pravilnika br.02/2010 o Procedurama

Rekrutovanja u Civilnoj Službi član 22 stav 3, produžava rok konkursa objavljeno datuma

06.06.2019 za jos 7 (sedam) drugih kalendarskih dana, sa obzirom da nije postignut

balansirani prijem broja aplikacija iz ctničkog i pol aspekta, za pozicije :

Službenik za logistiku (1 pozicije)

Uslovi za položaj ostaju isti kao u prethodnom konkursu. Kandidati koji su se prethodno prijavili za poziciju navedenog oglasa, ne moraju da se ponovo prijave.

Odeljenja za Administraciju / RAŽ.

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtine, Kosove
Tel:+381 38 22 00 40
Fax: +381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnica i Klinicka Sluzba Kosova-Hospital and University Clinical
Service of Kosovo

Centar za mentalno zdravlje sa Kućom za integraciju zajednice – Uroševac

Br.p 284/2019 datum 20.06.2019

SHPSIIB u Uroševcu, na osnovu člana 8, tačke 1 i 2 Zakona o radu br. 03 / 1-212; Član 4 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju procedure za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru; Član 5, stavovi 1 i 2 Uredbe o radnim odnosima br. 1003/2016; na osnovu zahtjeva odobrenog od strane direktora SHSKUK-a 17.06.2019, objavljuje:

JAVNI KONKURS

Naziv radnog mesta	QSHMSHIB u Uroševcu	Br. pozicija
I. Lckarka specijalista za psihijatriju		Jedan (1)

Institucija: QSHMSHIB u Uroševcu
Norma rada: Puni raspored,
Ugovor: Prema važećem propisima
Naziv posla: Specijalista psihijatra
Izvestava: Direktor u QSHMSHIB u Uroševcu
Funkcionalna kategorija/stepen: H-DOKTOR – SPECIJALISTA
Koeficijent 8.4 H-659/1

Naziv posla: Lckarka specijalista za psihijatriju

Glavni zadaci:

- Sprovođenje i poštovanje zakonodavstva
- Procijeniti, dijagnosticirati, liječiti i pratiti stanje mentalnog zdravlja klijenata u MSC/MIB, okruženju u kojem žive i pratiti cjelokupno zdravstveno stanje klijenata.
- Organizovati i učestvovati u primarnoj, sekundarnoj i tercijarnoj prevenciji zajedno sa timom za mentalno zdravlje i drugim agencijama / institucijama.
- Raditi u koordinaciji sa drugim profesionalnim profilima (medicinske sestre, socijalni radnik, psihosocijalni savjetnik, psiholog i drugi psihijatri) u MSC / SHIB-u na osnovu principa timskog rada.
- Doprinijeti koordinaciji sa multidisciplinarnim timom kako bi se odgovorilo na stvarne potrebe brige o mentalnom zdravlju klijenata i pružanju najboljih usluga.
